



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 1/2019 regjistër (JR)
Datë 08.01.2019

Nr. 23 i vendimit
Datë 23.09.2019

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Luan Daci	Kryesues
Natasha Mulaj	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 23.09.2019, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 1, datë 08.01.2019, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Liçaj, gjyqtare me detyrë kryetare pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 78, datë 15.11.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 62 e vijues, neni 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Natasha Mulaj, analizoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim "Komisioni"), me vendimin nr. 78, datë 15.11.2018, ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Liçaj, gjyqtare (kryetare) në Gjykatën e Apelit Vlorë.
2. Komisioni arriti në këtë përfundim pasi administroi tri raportet e vlerësimit, të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim "ILDKPKI") në bazë të neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim "DSIK") në bazë të neneve 34-39 të ligjit nr. 84/2016 dhe nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim "KLD") në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, duke vendosur të përfundojë procesin e rivlerësimit vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë, pa vendosur mbi kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional.
3. Trupi gjykues i Komisionit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, zhvilloi seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, arriti në përfundimin se:
 - i. *Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij, sipas nenit D pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.*
 - ii. *Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.*
 - iii. *Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*
 - iv. *Subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin ndaj publikut, në përputhje me nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.*
4. Në përfundim të procesit të rivlerësimit vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni arriti në përfundimin që subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Liçaj, gjyqtare (kryetare) në Gjykatën e Apelit Vlorë, t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

II. Shkaqet e ankimit

5. Kundër vendimit nr. 78, datë 15.11.2018, të Komisionit ka paraqitur ankim subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Liçaj, e cila kërkon ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmimin e saj në detyrë.

II/1. Shkaqe procedurale të ankimit

6. Zhvillimi i hetimit administrativ nga Komisioni vetëm për kriterin e pasurisë është bërë në shkelje të hapur të përcaktimeve kushtetuese, konkretisht nenit Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, dispozita në të cilat ligjvënësi ka parashikuar në mënyrë të qartë se

procesi i rivlerësimit kryhet i bazuar në tri kriteret dhe në asnjë rast nuk parashikohet kompetenca e Komisionit për ta mbyllur procesin vetëm për një kriter.

7. Vendimi i Komisionit që rrëzon kërkesën e subjektit të rivlerësimit për të përfshirë në procesin e rivlerësimit edhe dy kriteret e tjera, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, nuk është i arsyetuar si vendim i ndërmjetëm, si dhe nuk i është njoftuar subjektit të rivlerësimit përpara caktimit të seancës dëgjimore, i arsyetuar me pretendimin se kjo do të bëhej së bashku me vendimin përfundimtar.
8. Subjekti i rivlerësimit është kontrolluar disa herë nga ILDKPKI-ja, madje edhe përmes kontrollit të plotë, dhe ka rezultuar në rregull, duke qenë se ndaj saj nuk është aplikuar asnjëherë ndonjë sanksion administrativ.
9. Procesi administrativ, seanca dëgjimore dhe vendimmarrja e Komisionit nuk janë realizuar në përputhje me parimet për një proces të rregullt ligjor, të ligjshmërisë, të drejtësisë dhe paanësisë, të proporcionalitetit të dhënies së një vendimi të bazuar në ligj e në prova.
10. Subjekti i rivlerësimit nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha se dyfishi i pasurisë së ligjshme apo nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur.

II/2. Shkaqe ankimi për kriterin e vlerësimit të pasurisë

11. Për pasurinë “apartament banimi”, me sipërfaqe 107,08 m², Nr. {***} (2+1), ndodhur në katin e gjashtë + vendparkim me nr. {***}, ndodhur në rr. "{***}", Tiranë, me vlerë 97.664 euro, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.12.2009, të lidhur me shoqërinë “A.C” ShPK, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar këto shkaqe ankimi:

a) Konkluzionet e Komisionit se ka deklarim të rremë për sa i përket diferencës prej 25.664 eurosh në pagesën e çmimit të apartamentit të përfituar si ulje nga shoqëria ndërtuese, janë të gabuara pasi:

- i. situacionet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për vitet 2010, 2011 dhe 2012 nuk kanë asnjë kundërshti me deklaratimet e subjektit në procesverbalet e mbajtura në ILDKPKI në vitin 2010 e 2014;
- ii. subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrim ligjor të deklarojë shpenzimet për punët e kryera në apartament nga viti 2010 deri në vitin 2015, pasi ato kanë qenë në vlerë më të ulët se vlera e parashikuar nga ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, si dhe zbritja është kryer më datë 15.12.2016;
- iii. nuk ka fiktivitet të përmbajtjes së situacioneve të punimeve të kryera në vitet 2010, 2011, 2012 dhe 2015;
- iv. është e pavërtetë që situacionet janë të pashoqëruara me dokumentacion rakordimesh, sepse ato janë të nënshkruara nga inxhinieri i shoqërisë dhe bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në cilësinë e porositisit;
- v. subjektit të rivlerësimit nuk i është kërkuar dhe as i është ngarkuar barra e provës për të paraqitur dokumentacion për tagrin e përfaqësimit të firmës ndërtuese nga inxhinieri tjetër i cili ka firmosur situacionet;
- vi. dorëzimi efektiv i apartamentit është bërë më datë 20.12.2016, sipas procesverbalit përkatës mes përfaqësuesit të shoqërisë ndërtuese dhe bashkëshortit të subjektit dhe jo në vitin

2014.

b) Janë të pabazuara konkluzionet e Komisionit lidhur me kontratën e huas në vlerën 60.000 euro nga shtetasi A.M. pasi:

- i. shtetasi A.M. ka pasur aktivitet ekonomik e për rrjedhojë ka siguruar të ardhura, por përveç këtyre të ardhurave ky shtetas ka pasur edhe likuiditete të tjera në sistemin bankar të cilat nuk lidhen me statusin e tij si person fizik. Ka qenë jashtë mundësive objektive të subjektit për të siguruar të dhëna për të ardhurat e shtetasit A.M. në sistemin bankar apo ZVRPP, sepse ai ka ndërruar jetë në vitin 2013;
- ii. pagesat periodike për shlyerjen e huas janë deklaruar rregullisht në çdo deklaratë periodike të pasurisë deri në mbylljen e kontratës së bashku me interesin periodik vjetor 3%.
- iii. Është shpjeguar në mënyrë të vërtetë dhe bindëse se kontrata është mbyllur 8 muaj përpara afatit, në kushtet e nevojës ekstreme të huadhënësit për t'u likuiduar më parë në kohë, duke hequr dorë nga interesat e vitit të fundit të kontratës, pasi ishte ekzaminuar me një sëmundje të rëndë.

c) Janë kontradiktore dhe të pabazuara konkluzionet e Komisionit lidhur me huan 12.000 euro të marrë nga vëllai i bashkëshortit pasi:

- i. kjo hua nuk është deklaruar në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë të vitit 2009 për shkak të mungesës së njohurive të përshtatshme për plotësimin e deklaratës së pasurisë, duke qenë se huaja ishte dhënë pa kontratë e pa interes, si dhe në kushtet e marrëdhënies familjare nuk do të ishte i nevojshëm deklarimi i saj;
- ii. huaja nuk është fiktive dhe kjo vërtetohet me deklaratën noteriale të z. A.L., me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.12.2010, dhe me shpjegimet e dhëna nga subjekti në ILDKPKI në datën 20.12.2010 dhe 15.09.2014;
- iii. nuk është ndërmarrë asnjë hap për të fshehur këtë hua, duke qenë se ajo është deklaruar në mënyrë të rregullt që nga viti 2010 dhe jo siç arsyeton Komisioni nga viti 2013;
- iv. ky deklaram i pasaktë potencialisht mund të përbënte kundërvajtje administrative sipas ligjit të kohës për deklarimin e pasurisë, por jo rast për zbatimin e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016;
- v. Komisioni në praktikën e vet vendimmarrëse (shih vendimet nr. 49, datë 25.07.2018, nr. 56, datë 01.08.2018 dhe nr. 58, datë 01.08.2018) ka pranuar se dokumenti ligjor prej ku fillon të evidentohen përgjegjësitë e subjektit për shkelje disiplinore është pikërisht deklarata e pasurisë *vetting* 2017 dhe të dhënat që ajo përmban, për pasojë deklarimi i subjektit është i saktë për këtë hua;
- vi. referuar faktit që shtetasi A.L. nuk e ka deklaruar këtë hua në deklaramet e tij të pasurisë, kjo mund të përbëjë shkelje administrative prej tij, por jo të ngarkojë subjektin me përgjegjësi;
- vii. personi tjetër i lidhur, z. A.L., ka pasur mundësi financiare për të dhënë huan sepse, që nga viti 2005, ai është administrator i shoqërisë "L" ShPK, dhe në cilësinë e bashkëpronarit të truallit në masën 15% ka lidhur një kontratë investimi për ndërtim, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.04.2005, duke realizuar një ndërtim shumëkatësh, nga i cili ka përfituar 2109 m² ndërtim, të përbërë nga apartamente, njësi shërbimi e garazhe, që i ka tjetërsuar apo dhënë me

qira, duke përfiturar të ardhura të konsiderueshme, të deklaruara dhe të justifikuara sipas deklarimeve periodike që ai vetë ka bërë në ILDKPKI, në kuadër të detyrës së tij shtetërore.

ç) Është i pabazuar konkluzioni i Komisionit se ka mungesë burimesh financiare të ligjshme të shtetasit K.S. për të dhënë huan në shumën 30000 euro, pasi ky shtetas ka pasur aktivitet ekonomik dhe, për rrjedhojë, ka siguruar të ardhura të mjaftueshme. Veç këtyre të ardhurave, ky shtetas ka pasur edhe të ardhura të tjera nga familjarët e tij me të cilët bashkëjeton, konkretisht prindërit e tij i kanë dhënë me qira një ambient në vlerën 5.500 USD në muaj, që prej vitit 2009, sipas kontratës së qirasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.05.2009, me afat 7-vjeçar, shoqërisë "E.I" ShPK, nga e cila kanë përfiturar deri në vitin 2013, shumën 330.000 USD. Edhe pse në rolin e përfituesit të qirasë janë prindërit e shtetasit K.S., nga certifikata familjare provohet qartësisht se ata jetojnë së bashku në një banesë dhe në një trung të përbashkët familjar.

12. Për pasurinë "apartament banimi", me sipërfaqe 100,68 m² dhe vendparkim, ndodhur në rr. "{***}", Tiranë, me vlerë 60.000 euro, sipas kontratës për kalim të drejtash reale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.07.2016, të lidhur mes shtetasve P.Ç. e P.Z. dhe shoqërive "A.C." ShPK e "B" ShPK, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar këto shkaqe ankimi:

a) Nuk ka asnjë kontradiktë midis përmbajtjes së kontratës për kalim të drejtash reale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.07.2016, sipas së cilës deklarohet se çmimi është paguar pjesë-pjesë më parë, dhe faktit se pagesa është bërë e menjëhershme. Pagesa pjesë-pjesë nënkupton që shuma nuk është dhënë brenda ditës, por një pjesë është dhënë para hartimit të kontratës dhe pjesa tjetër pas nënshkrimit të saj, në një periudhë më pak se dyjavore, duke mos pasur kështu asnjë detyrim për deklaram periodik të mëparshëm në ILDKPKI.

b) Në lidhje me çmimin e blerjes së këtij apartamenti, ai është përcaktuar në përputhje me lirinë kontraktuale të palëve. Fakti që vlera e apartamentit, sipas Udhëzimit të Entit Kombëtar të Banesave Nr. {***}, datë 28.12.2016, "Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave", është 121.491 euro, kjo nuk mund të përdoret si vlerë reale apo orientuese e apartamentit, pasi kjo do të binte ndesh me parimet bazë të marrëdhënieve juridiko-civile, të cilat qëndrojnë në themel të një shoqërie demokratike, që funksionon mbi bazën e parimeve të tregut të lirë.

c) Deklarimi i verandës së apartamentit përfshihet në deklaramin e kontratës për kalim të drejtash reale, që është bërë si në deklaratën e pasurisë *vetting* 2017, ashtu edhe në deklaratën e pasurisë së vitit 2016, së bashku me dokumentacionin shoqërues. "Veranda" është pjesë përbërëse e apartamentit, referuar skicës planimetrike dhe është e përfshirë në çmimin e apartamentit sipas nenit 2 të kontratës. Pra, kjo pasaktësi në deklaram nuk përbën fshehje të pasurisë.

ç) Shtetasi L.S. ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të dhënë hua në shumën 70.000 euro, nga shoqëria "L" ShPK, ku ka qenë ortak me 50%. Fakti që ai ka kaluar në status pasiv në vitin 2013, me një humbje prej 35.738 lekësh, nuk mund të mohojë faktin që ai ka pasur likuiditete nga të ardhurat e tij ndër vite. Vetëm fitimi për periudhën 2008-2013, siç pranon edhe Komisioni në vendim, është 15.169.370 lekë. Sa i takon mosshpërndarjes së dividendit, kjo mund të lidhet me

avantazhet financiare që kanë ortakët për të evituar pagimin e tatimit përkatës mbi dividendin.

d) Hapja e librezave të ujit dhe të energjisë elektrike është bërë nga shoqëria ndërtuese, në marrëveshje mes pronarëve të mëparshëm të apartamentit, pasi më parë kishte dakordësi mes palëve për blerjen e kësaj pasurie në momentin që do të sigurohej shuma përkatëse e çmimit. Gjithashtu, lidhja e këtyre kontratave të furnizimit me ujë dhe energji është veprim i kryer nga ndërmarrjet përkatëse UKT ShA dhe OShEE ShA.

13. Për pasurinë "apartament banimi me sipërfaqe 71,8 m²", regjistruar në ZVRPP Vlorë me nr. pasurie {***}, vol. {***}, f. {***}, ZK {***}, e krijuar nga kontrata e shkëmbimit me Ndërmarrjen Elektrike Vlorë, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur këto shkaqe ankimi:

a) Përkundër arsyetimit të Komisionit, nuk ka asnjë motiv për të vënë në diskutim vlefshmërinë e kontratës së shkëmbimit pasi:

i. kontrata është lidhur nga personi i lidhur M.L. në vitin 2000, përpara lidhjes së martesës me subjektin e rivlerësimit;

ii. kontrata është depozituar si provë shkresore që në deklarin e parë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në vitin 2003;

iii. është lidhur nga titullari i Ndërmarrjes Elektrike me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në emër dhe për llogari të institucionit;

iv. fakti që ZVRPP Vlorë nuk ka dokumentacion mbi këtë pronë, nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi bashkëshortin e subjektit;

v. mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme sipas nenit 32, pika 2 të ligjit nr. 84/2016.

b) Kjo pasuri është përfituar nga bashkëshorti i subjektit përpara martesës dhe rezulton e regjistruar në ZVRPP Vlorë përpara se subjekti të martohet me të, çfarë do të thotë se përfitimi i kësaj pasurie nuk është rrjedhojë e ndonjë ushtrimi të ndikimit për shkak të detyrës apo nga burime financiare të paligjshme. Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 30 i ligjit nr. 84/2016 parashikojnë hetimin administrativ të pasurisë së subjektit të rivlerësimit të krijuar gjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtare, pra në rastin konkret që nga viti 2000, si dhe të pasurive të përftuara nga bashkëshorti si person i lidhur, në rastin konkret që nga viti 2003, pra pas lidhjes së martesës duke qenë se qëllimi i ligjit nr. 84/2016 është kontrolli i pasurive të krijuara nga subjekti në cilësinë e gjyqtarit gjatë kohës së ushtrimit të funksionit.

14. Për pasurinë "ndërtesë me sipërfaqe 120 m² dhe truall funksional me sipërfaqe 215 m²", me nr. pasurie {***}, e regjistruar në vol. {***}, f. {***}, e ndodhur në ZK {***}. Pasuri e krijuar sipas lejes së ndërtimit nr. {***}, datë 16.08.1991, të Komitetit Ekzekutiv Pluralist të Qytetit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar këto shkaqe ankimi:

a) Komisioni ka gabuar kur arrin në përfundimin se posedimi i truallit ka qenë i paligjshëm për shkak se leja e ndërtimit është deklaruar false nga Arkivi Shtetëror Vendor Vlorë. Nga ZVRPP Vlorë është lëshuar rregullisht certifikatë pronësie së paku deri në vitin 2012, ndërkohë që

procedimi penal lidhur me falsitetin e lejes është ende në proces hetimi paraprak. Për pasojë, leja e ndërtimit për këtë ndërtesë është ende në fuqi dhe e ligjshme, sepse nuk ka ende një vendim të formës së prerë që të ketë deklaruar falsitetin e këtij dokumenti.

b) Leja e ndërtimit (vetëm lista shumemërore) është deklaruar e falsifikuar gjatë një procesi civil në vitin 2008, ku subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë qenë palë, e për pasojë nuk kanë pasur dijeni për këtë fakt. Subjekti është vënë në dijeni të këtij fakti vetëm në vitin 2016, kur është njoftuar pas një kërkesë të vetë subjektit nga Arkivi Shtetëror Vendor Vlorë. Për këto arsye, duke qenë se subjekti nuk mund të parashikonte falsitetin e një dokumenti përpara se ai të deklarohet i tillë, deklarimi i tij ka qenë i saktë dhe në përputhje me ligjin.

c) Është i gabuar qëndrimi i Komisionit kur konsideron si deklarim të pasaktë mosdeklarimin e sipërfaqes së çdo kati, pasi përshkrimi i një pasurie të paluajtshme jepet sipas pasqyrimin në regjistrimin e ZVRPP-së. Pra, ndërkohë që në deklarimin i pasurisë *vetting* 2017 pasqyrohet sipërfaqja totale që zë ndërtesa dhe që është e njëjtë, pra 120 m², siç pasqyrohet në ZVRPP Vlorë, në deklarimin e pasurisë së vitit 2003, deklarimi i sipërfaqes së truallit 300 m² i referohet gjendjes juridike të sipërfaqes së këtij trualli sipas dokumentit *leje ndërtimi*, ku pasqyrohet 15 m x 20 m, pra 300 m².

ç) Banesa ka filluar të ndërtohet që në vitin 1991 nga bashkëshorti, 12 vjet para martesë, dhe nuk ka pasur shtesë të sipërfaqes apo shtesë kati në këtë banesë. Deklarimi për ndërtesë 3 kate është bërë në përputhje me ZVRPP Vlorë, ndërkohë që sa i takon verifikimit në terren nga ALUIZNI Vlorë, i cili ka pasqyruar 4 kate, ka konsideruar si kat ndërtimi edhe bodrumin.

d) Në përfundim, për shkak se sipërfaqja e kësaj pasurie nuk ka ndryshime, sipërfaqja e truallit në posedim është zvogëluar dhe jo shtuar, si dhe nuk ka shtim të kateve të ndërtesës, gjetjet e Komisionit nuk janë relevante e për pasojë nuk mund të zbatohet neni 61 i ligjit nr. 84/2016.

dh) Në vendimin e Komisionit nuk është arsyetuar as qëllimi për të fshehur pasurinë dhe as rrethanat konkrete për të konstatuar deklarimin e rremë në përputhje me nenin 33, pika 5, geramat "c" dhe "ç" të ligjit nr. 84/2016.

e) Edhe sikur leja e ndërtimit të deklarohet e falsifikuar, ndërtesa është ndërtuar që në vitin 1991, dhe nga ligji i kohës nr. 8405, datë 17.09.1998, "Për urbanistikën", ndërtimi i paligjshëm nuk parashikohej si vepër penale, por si shkelje administrative.

ë) Është i pambështetur në ligj konkluzioni i Komisionit se posedimi i truallit prej bashkëshortit të subjektit dhe subjektit është i paligjshëm pasi aplikimi i bërë nga ana e tyre tek ALUIZNI Vlorë është bërë pikërisht për të legjitimuar një marrëdhënie juridike pronësie me truallin. Ndërkohë, lidhur me posedimin, Kolegji duhet t'i referohet nenit 169 të Kodit Civil, ku parashikohet parashkrimi fitues pa titull, pasi trualli mbi të cilin është ndërtuar objekti posedohet nga bashkëshorti që prej vitit 1991 dhe, duke kryer përlllogaritjet që nga data e hyrjes në fuqi të Kodit Civil, më 01.11.1994, që parashikon dispozitën e parashkrimit fitues pa titull, afati për të

fituar pronësinë mbi truallin (që është send në qarkullim civil pa pengesë për tjetërsim), plotësohet më datë 01.11.2014, e për këtë arsye posedimi mbi këtë truall është i ligjshëm.

f) Kjo pasuri është e regjistruar në emër të bashkëshortit të subjektit që përpara martesë dhe dokumentacioni për regjistrimin e saj bazohet në lejen e ndërtimit, nxjerrë sipas vendimit të Komitetit Ekzekutiv Pluralist të Qytetit Vlorë, nr. {***}, datë 16.08.1991, "Për dhënie leje ndërtimi". Për këtë arsye, Komisioni në dhënien e vendimit duhet të mbante në konsideratë zbatimin e parimit të proporcionalitetit duke vlerësuar veprimet aktive të subjektit për të përfituar këtë pasuri, pasi rezulton që ajo të jetë ndërtuar, poseduar e përfituar nga bashkëshorti përpara martesës, duke mos pasur kështu rrjedhje të ushtrimit të ndikimit për shkak të detyrës si gjyqtare.

15. Për pasuritë "njësi me sipërfaqe 43 m²", "njësi me sipërfaqe 95 m²" dhe "garazh me sipërfaqe 35 m²", me adresë rr. "{***}", Godina {***} kate, Vlorë, pronësia e të cilave është fituar me kontratën e dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.02.2016, të lidhur me dhuruesin A.L. dhe pranuesin e dhurimit M.L. ", subjekti i rivlerësimit ka parashtruar këto shkaqe ankimi:

a) Është i gabuar konkluzioni i Komisionit se nuk është deklaruar vlera e këtyre pasurive, pasi kontrata e dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.02.2016, nuk përmban vlerë të pasurive.

b) Është i gabuar dhe i pambështetur në ligj konkluzioni i Komisionit se kontrata e dhurimit është fiktive, pasi nuk u paraqit kontrata e investimit dhe bashkëpunimit mes tri shoqërive "L" ShPK, "{***}" ShPK dhe "A" ShPK, si dhe asnjë dokumentacion ligjor për miratimin nga asambleja e përgjithshme e shoqërive për pasqyrimin në pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së këtyre shoqërive të pasurive të dhuruara.

c) Z. A.L. i ka përfituar këto pasuri (të cilat ia ka dhuruar më pas bashkëshortit të subjektit) në cilësinë e bashkëpronarit me 15% të truallit, mbi të cilin është bërë ndërtimi. Shtetasit A.L. i janë dhuruar këto pasuri nga tri shoqëritë ndërtuese/investitore për shkak të një kredie të marrë në BKT.

ç) Nuk ka asnjë detyrim ligjor që asambleja e përgjithshme e ortakëve apo ortaku i vetëm të marrë një vendim konkret për kalimin në pronësi të shtetasit A.L. të pasurive përmendur më sipër.

d) Mosdeklarimi në deklaratën e pasurisë të vitit 2015 nga shtetasi A.L. të përfitimit të këtyre pasurive, është përgjegjësi e tij dhe jo e subjektit të rivlerësimit.

dh) Nuk është i vërtetë konkluzioni i Komisionit se shtetasi A.L. ka përfituar vetëm pasuritë që i ka dhuruar vëllait nga ky ndërtim, por ai ka përfituar ndërtim me sipërfaqe 2109 m², të përbërë nga zyra me sipërfaqe 73 dhe 78 m², një ambient palestër 202 m² etj.

e) Së bashku me ankimin, subjekti i rivlerësimit për këtë shkak ankimi ka paraqitur aktet e mëposhtme, si dhe kërkesën për marrjen në shqyrtim të tyre:

- i. Aktmarrëveshje me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.07.2006, nënshkruar mes 3 shoqërive, "L" ShPK, "{***}" ShPK dhe "A" ShPK, për ndërtimin në rr. "{***}", Vlorë dhe menaxhimin e punimeve.
 - ii. Kontratë investimi me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.04.2005, lidhur midis pronarëve të truallit dhe palës investitore, me objekt ndërtimin në rr. "{***}", Vlorë të një kompleksi ndërtesash me sipërfaqe 1713 m² dhe truall me sipërfaqe 8400 m².
16. Për pasurinë "automjet, tip Benz 140, me targa {***}", subjekti i rivlerësimit ka parashtruar këto shkaqe ankimi:
 - a) Nuk ka asnjë fiktivitet në çmimin e blerjes së këtij automjeti, pasi ai është blerë okazion, me kushtet teknike që ka pasur në momentin e shitjes ndërkohë që, vlera 500.000 lekë në vitin 2002 ka qenë një shumë e konsiderueshme. Pas blerjes, automjetit i janë bërë shërbime mirëmbajtje e përmirësimi, si dhe nuk ka pasur konsum apo amortizim, duke qenë se bashkëshorti ka përdorur një automjet tjetër në pronësi të tij.
 - b) Argumentet e Komisionit lidhur me këtë pasuri bien ndesh me parimet e një ekonomie të lirë tregu që karakterizohet nga liria kontraktuale, sipas së cilës palët janë të lira të përcaktojnë çmimin e shitjes apo të blerjes.
 - c) Nuk ka pasur asnjë ndalim ligjor për likuidimin e çmimit të blerjes në *cash*.
 - ç) Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë detyrim ligjor për të ruajtur dokumentacionin për shërbimet që i janë kryer automjetit, pasi asnjë prej tyre nuk tejkalon limitin e shpenzimeve të deklarueshme, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9049/2003.
17. Për pasurinë "automjet, tip Benz Mercedes, me targa {***}", subjekti i rivlerësimit ka parashtruar këto shkaqe ankimi:
 - a) Referuar DIPPV 2013, shtimi i gjendjes *cash* në shumën 15.000 euro nuk ka ardhur nga shitja e mjetit me targa {***}, për pasojë nuk ka vend për të diskutuar për fiktivitet me qëllim për të mbuluar shlyerjen e huas.
 - b) Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrim ligjor të deklarojë automjetin që në vitin 2007, pasi referuar DRShTRr Vlorë, në këtë vit automjeti nuk ka qenë në pronësi të shtetasit M.L., por në pronësi të shtetasit G.Sh. Bashkëshorti e ka blerë automjetin në vitin 2009.
 - c) Sa i takon çmimit të blerjes së këtij automjeti në vlerën 600.000 lekë, fakti që më vonë mjeti ka rezultuar të ketë qenë i vjedhur, e justifikon plotësisht çmimin e ulët të blerjes së tij, të cilin bashkëshorti e ka konsideruar si okazion. Ndërkohë, çmimi i shitjes në vlerën 20.000 euro justifikohet plotësisht edhe nga arsyetimi i Komisionit në vendim, sipas të cilit vetëm taksa doganore për këtë automjet është në shumën 784.783 lekë, për rrjedhojë vlera e makinës ka qenë 3.500.000 lekë, pra çmimi i shitjes prej 20.000 eurosh është madje nën vlerën reale të mjetit.

ç) Nuk ka pasur asnjë ndalim ligjor për likuidimin e çmimit të blerjes në *cash*. Likuidimi i çmimit përmes llogarisë bankare të noterit është detyrim ligjor për blerjen e pasurive të paluajtshme, por jo për sendet e luajtshme.

d) Është i pavërtetë konkluzioni i Komisionit se ekzistojnë 2 kontrata për këtë automjet, kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.08.2010, lidhur para noteres L.C dhe kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.06.2010, lidhur para noteres Sh.Gj. Pas kontaktit me noteren Sh.Gj., kjo e fundit i ka konfirmuar subjektit të rivlerësimit se ajo nuk e ka përpiluar këtë kontratë dhe se pranë zyrës së saj noteriale nuk ekziston një kontratë e tillë.

18. Për pasurinë "automjet, tip Benz Mercedes, me targa {***}", subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se shuma 1.000.000 lekë, e deklaruar në deklaratën e dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.10.2015, mund të jetë shkruar *apriori* nga noterja, në mungesë të kontratës së parë të blerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.04.2014, për mjetin tip BMW, me targë {***}, pasi kontrata e shkëmbimit me shtetasin M.M. nuk e ka vlerën e secilit mjet që shkëmbehet.
19. Për pasurinë "automjet, tip Volkswagen, me targa {***}", subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se nuk është kërkuar dokumentacion dhe as nuk është kaluar barra e provës për këtë mjet, për rrjedhojë kjo pjesë e vendimit nuk është e bazuar në provat e marra gjatë hetimit të çështjes.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

20. Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Liçaj, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Ajo është hetuar dhe gjykuar nga Komisioni vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke mos marrë vendim për dy kriteret e tjera, atë të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

III/1. Vlerësimi i trupit gjykues lidhur me shkaqet procedurale

21. Lidhur me pretendimin në ankim se hetimi i Komisionit vetëm për kriterin e pasurisë është në shkelje të Kushtetutës, vlerësojmë se vendimi i Komisionit për të proceduar vetëm me gjykimin e një kriteri është në përputhje me nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, i cili shpreh qartë se: "Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave." Në bazë të këtij parashikimi ligjor, Komisioni ka filluar hetimin administrativ për të tria kriteret e vlerësimit, dhe pasi ka vlerësuar se e ka hetuar në mënyrë të plotë kriterin e pasurisë, bazuar në provat e grumbulluara dhe vlerën e tyre provuese, ka arritur në përfundimin se vlerësimi i subjektit të rivlerësimit mund të bëhet edhe vetëm për kriterin e pasurisë, pa qenë nevoja e përfundimit të hetimit të plotë edhe të dy kriterëve të tjera.

22. *Lidhur me pretendimin se vendimi i Komisionit që rrëzon kërkesën e subjektit të rivlerësimit për përfshirjen në proces edhe të dy kritereve të tjera, veç pasurisë, nuk është i arsyetuar si vendim i ndërmjetëm, si dhe nuk i është njoftuar subjektit, trupi gjykues vlerëson se në ligjin nr. 84/2016 nuk gjen rregullim të posaçëm vendimmarrja e Komisionit lidhur me këtë kërkesë të subjektit, e për pasojë Komisioni ka pasur të drejtën/detyrimin ta arsyetojë vendimmarrjen e tij në vendimin përfundimtar.*
Në ligjin nr. 84/2016 nuk është parashikuar as e drejta e ankimit të veçantë lidhur me vendimmarrje të tilla të Komisionit, kjo në kuptim të faktit që subjektit nuk i është mohuar e drejta për t'u ankuar ndaj vendimit të Komisionit, duke pasur mundësinë ta bëjë këtë, së bashku me ankimin ndaj vendimit përfundimtar. Pra, edhe sikur të ndodheshim në rastin që subjektit të rivlerësimit t'i njoftohej vendimi (i ndërmjetëm) i arsyetuar, sërish ankimi për të do të mund të bëhej vetëm së bashku me ankimin ndaj vendimit përfundimtar të Komisionit, duke mos ndryshuar kështu asgjë në pozitën procedurale të subjektit të rivlerësimit.
23. *Lidhur me pretendimin në ankim se subjekti është kontrolluar disa herë nga ILDKPKI-ja dhe ka rezultuar në rregull, vlerësojmë se procesi i rivlerësimit është një proces tërësisht i ri, i bazuar në një legjislacion të posaçëm, mbi bazën e të cilit kryhet rivlerësimi i kritereve të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, ndër të tjera shpjegohet se: [...] në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse. Për rrjedhojë, është i pabazuar ky pretendim i ankuesit.*
24. *Lidhur me pretendimin se procesi administrativ, seanca dëgjimore, si dhe vendimmarrja e Komisionit nuk janë realizuar në përputhje me parimet për një proces të rregullt ligjor, të ligjshmërisë, të drejtësisë dhe paanësisë, të proporcionalitetit, të dhënies së një vendimit të bazuar në ligj e në prova etj., vlerësojmë se procesi administrativ, seanca dëgjimore, si dhe vendimmarrja e Komisionit janë realizuar në përputhje me parimet për një proces të rregullt ligjor, të ligjshmërisë, të drejtësisë dhe paanësisë, të proporcionalitetit, të dhënies së një vendimit të bazuar në ligj e në prova.*
25. *Sa i takon vlerësimin tërësor të procedurave, e gjejmë të drejtë qëndrimin e Komisionit se, për vlerësimin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Liçaj, dhe personi i lidhur me të kanë kryer një sërë veprimesh juridike fiktive, të cilat nuk përputhen me sjelljet që një gjyqtarë pritët të ketë, duke cenuar në këtë mënyrë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.*

III/2. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

Lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Liçaj, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim "ligji nr. 9049, datë 10.04.2003"), i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, “Për

parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (në vijim "ligji nr. 9367, datë 10.04.2005"), i ndryshuar.

ILDKPKI-ja, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, me shkresën nr. {***} prot., datë 17.11.2017, i ka dërguar Komisionit raportin përfundimtar në të cilin ka konkluduar se deklarimi është i pasaktë, nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, ka kryer fshehje të pasurisë, ka kryer deklarim të rremë, si dhe subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

26. Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Liçaj, referuar *e-mail*-it të sekretarisë gjyqësore të Kolegjit, me të cilin është njoftuar për ditën e seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 23.09.2019, ka kërkuar shtyrjen e seancës gjyqësore me pretendimin se, për shkaqe shëndetësore, nuk do të jetë në Shqipëri nga data 20.09.2019 deri në datën 30.09.2019. Për këtë pretendim, deri ditën e gjyqimit, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë dokument. Lidhur me këtë kërkesë të subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, i cili parashikon se: "Shqyrtimi i ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit", trupi gjykues vlerëson se prania e subjektit të rivlerësimit në dhomë këshillimi nuk është e parashikuar në ligj. Ndërkohë, sa i takon të drejtës së subjektit të rivlerësimit për të paraqitur parashtrimet e tij lidhur me ankimin e paraqitur në Kolegj, kjo e drejtë e subjektit parashikohet nga neni 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, ku specifikohet se: "Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim". Sipas kësaj dispozite ligjore, subjekti ka pasur mundësi t'i paraqesë parashtrimet e tij deri më datë 18.09.2019, që do të thotë deri 2 ditë përpara se të largohet nga Shqipëria. Për këto arsye, trupi gjykues vendosi të mos pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për shtyrjen e seancës gjyqësore në dhomë këshillimi.

III/2. Vlerësimi i trupit gjykues për kriterin e vlerësimit të pasurisë

27. Lidhur me këtë kriter të rivlerësimit, u analizuan nga trupi gjykues pasuritë si më poshtë.
28. Pasuria "apartament me sipërfaqe 107,08 m² dhe vendparkim", ndodhur në rr. "{***}", Tiranë.

Për këtë pasuri Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit:

- i. nuk ka provuar me dokumentacion ligjor provues mundësinë financiare të shtetasit A.M. për dhënien hua të shumës 60.000 euro;*
- ii. nuk ka provuar me dokumentacion ligjor provues mundësinë financiare të shtetasit K.S. për dhënien hua të shumës 30.000 euro;*
- iii. ka kryer deklarim të rremë lidhur me huan e marrë shtetasit A.L., në shumën prej 12.000 eurosh;*
- iv. ka kryer deklarim të rremë lidhur me uljen e përfiturar në shumën 25.664 euro, nga shoqëria ndërtuese për këtë apartament banimi, me sipërfaqe 107,08 m² dhe vendparkim me nr. {***}, sipas*

*kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.12.2009, për dorëzim me vonesë nga firma e ndërtimit dhe punime të kryera nga porositësi;*

v. në shpjegimet e tij nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit sipas nenit D, paragrafi 5 i Aneksit të Kushtetutës.

29. *Lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues konstaton se ajo është deklaruar për herë të parë nga personi i lidhur i subjektit të rivlerësimit, bashkëshorti i saj M.L., në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë të vitit 2009, ku deklaroi se deri në momentin e deklarimit janë likuiduar 72.000 euro të vlerës totale të çmimit 97.664 euro të apartamentit, nga zgjidhja e kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.12.2008, pagat dhe kursimet. Pjesa takuese është deklaruar 100% në pronësi të personit të lidhur. Në deklaratën e interesave privatë periodikë/ vjetorë të vitit 2009, nuk është deklaruar vendparkimi, i cili referuar nenit 2 të kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.12.2009, ka çmimin 12.000 euro.*

*Në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë të vitit 2016 është deklaruar si nga subjekti, ashtu dhe nga personi i lidhur se *diferenca e pagesës së mbetur pa shlyer në vlerën 25.664 euro është përfituar ulje nga kompania sipas marrëveshjes së palëve, bazuar në kontratën e sipërmarrjes për punime të kryera vetë dhe penalitete për shkak të vonesave në dorëzimin e objekteve.**

*Në deklaratën e pasurisë *vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë vendparkimin sipas kontratës së sipërmarrjes. Në këtë deklaratë, si nga subjekti, ashtu dhe personi i lidhur, si burim krijimi për këtë pasuri kanë deklaruar: i) kontratën e huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.10.2008, lidhur me z. A.M., për vlerën 60.000 euro; ii) huan në shumën 12.000 euro, të marrë vëllait të bashkëshortit të subjektit, z. A.L., më datë 02.12.2009; dhe iii) diferencën mes huave të marra (72.000 euro) dhe çmimit të apartamentit (97.664 euro) në shumën 25.664 euro, likuiduar si përfitim i uljes së vlerës nga shoqëria, si pasojë e mbylljes së llogarive me shoqërinë ndërtuese.*

*Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se ka mospërputhje midis deklarimit në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë 2009 dhe deklarimit në deklaratën *vetting* 2017, pasi në vitin 2009 subjekti i rivlerësimit deklaroi si burim zgjidhjen e kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.12.2008 lidhur mes personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. M.L., në cilësinë e "blerësit" dhe shoqërive "A.C" ShPK në cilësinë e "palës sipërmarrëse" e "B" ShPK në cilësinë e "palës investitore", pagën dhe kursimet, ndërsa në deklaratën *vetting* deklaroi si burim huan në vlerën 60.000 euro nga z. A.M. dhe huan në vlerën 12.000 euro nga vëllai i bashkëshortit, z. A.L. Trupi gjykues arrin në përfundimin se kjo pasaktësi në deklarime është e qëllimshme, duke qenë se më datë 20.12.2010, referuar procesverbalit të mbajtur në ILDKPKI gjatë një kontrolli të ushtruar në atë kohë, subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh financiare për të justifikuar pasurinë apartament më sipër, dhe një ditë më pas, më datë 21.12.2010, është nënshkruar para noterit deklarata noteriale e shtetasit A.L. për dhënien hua*

shtetasit M.L., në vlerën 12.000 euro, në datën 02.12.2009, rreth një vit para nënshkrimit të deklaratës.

*Lidhur me huan 60.000 euro, nga analiza e provave në dosjen gjyqësore, rezulton që huadhënësi A.M. ka qenë i regjistruar si person fizik në datën 12.04.2005. Deri në vitin 2008, vit në të cilin i është dhënë prej tij huaja 60.000 euro bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit M.L., si person fizik me NIPT {***}, A.M. ka realizuar nga aktiviteti ekonomik një fitim total prej 1.728.000 lekësh.*

Ndërkohë nga kontrata e huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.10.2008, ndërmjet personit të lidhur M.L. dhe personit tjetër të lidhur, A.M., mbështetur në përcaktimet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe pika 19 e udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së¹, subjekti i rivlerësimit, personi i lidhur dhe personi tjetër i lidhur, i deklaruar në cilësinë e huadhënësit, marrëdhënie kjo e konfirmuar nëpërmjet kontratës së huadhënies, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë në kuadër të nenit 32, pika 4 e këtij ligji, aftësinë e personit tjetër të lidhur që me të ardhura nga burime të ligjshme, të jepte hua shumën 60.000 euro.

*Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se shtetasi A.M. ka pasur likuiditete në sistemin bankar, por duke qenë se ai ka ndërruar jetë në vitin 2013, ka qenë jashtë mundësive objektive të subjektit për të siguruar të dhëna, trupi gjyqësor konstaton se informacioni që subjekti pretendon të mos ketë pasur mundësi objektive për ta vënë në dispozicion është siguruar nga Komisioni përmes përgjigjeve të bankave të nivelit të dytë në Shqipëri, në përgjigje të shkresës nr. {***} prot., 16.03.2018, të Komisionit. Referuar këtyre përgjigjeve, ka rezultuar që z. A. M. si individ dhe person fizik, ka pasur llogari bankare pranë Bankës Raiffeisen. Gjendja e llogarive bankare të z. A.M. në Bankën Raiffeisen, më 31.12.2005 ka qenë 56.120 lekë, më 31.12.2006 ka qenë 1.020.033,87 lekë, më 31.12.2007 ka qenë 2.196.052,35 lekë dhe më 31.12.2008 ka qenë 1.743.041,60 lekë. Pra, me të ardhurat e deklaruara, të ligjshme, të përfituara për periudhën 2005-2008 në shumën 432.000 lekë, z. A.M., përveçse ka dhënë huan 60.000 euro, ka krijuar edhe kursime në llogaritë bankare në vlerat: 963.913,87 lekë në fund të vitit 2006, 1.176.018,48 lekë në fund të vitit 2007 dhe 567.023,12 lekë në fund të vitit 2008, që shkon përtej mundësive financiare faktike të huadhënësit.*

Lidhur me kthimin e kësaj huaje, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ajo është shlyer me kursime nga paga, si dhe nga huaja prej 30.000 eurosh, marrë shtetasit K.S., me kontratën e huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.01.2013, lidhur mes huadhënësit K.S. dhe huamarrësit M.L. Sa u takon

¹ Udhëzimi nr. 4095, datë 10.10.2016, "Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", pika 19 parashikon: "Nëse personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit deklarojnë një marrëdhënie me persona të tjerë të lidhur (fizikë dhe juridikë) në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit dhe huamarrësit, detyrohen të paraqesin dokumentacionin justifikues ligjor të lëshuar nga institucionet shtetërore dhe private për personat e tjerë të lidhur, referuar burimit të krijimit të dhurimit, huadhënies dhe huamarrjes, dhënë personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit."

kursimeve nga paga të përdorura për shlyerjen e huas në vlerën 60.000 euro, trupi gjykues konstaton se në vitin 2008, vit në cilin është marrë huaja e mësipërme, personi i lidhur i subjektit të rivlerësimit ka shlyer 200.000 lekë sipas deklarimit periodik të pasurisë, duke lënë një gjendje detyrimi prej 58.500 eurosh. Ndërkohë sipas deklarimit të interesave privatë/periodikë vjetorë 2009, subjekti ka shlyer vlerën 650.000 lekë dhe ka lënë si gjendje detyrimi vlerën 50.000 euro. Në fakt, nëse i referohemi gjendjes së mbetur të detyrimit të deklaruar në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë 2009, rezulton që ulja e tij të ketë qenë në vlerën 8.500 euro ose rreth 1.122.510 lekë dhe jo 650.000 lekë siç është deklaruar në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë 2009. Nga përllogaritjet e kryera, pas uljes së detyrimit në vlerën 650.000 lekë sipas deklarimit, gjendja e detyrimit të mbetur në fund të vitit 2009 duhet të ishte 53.000 euro dhe jo 50.000 euro, si është deklaruar faktikisht.

*Lidhur me huan prej 30.000 euro marrë shtetasit K.S., nga shqyrtimi i dosjes gjyqësore rezulton se K.S. është i regjistruar si person fizik në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Vlorë, më datë 24.03.2005, me NIPT {***} dhe me status “aktiv” prej datës së regjistrimit e aktualisht. Qarkullimi gjatë ushtrimit të aktivitetit tregtar nga viti 2005 deri në momentin e dhënies së huas në datën 14.01.2013, ka qenë në vlerën 3.745.757 lekë, ndërsa fitimi rezulton të ketë qenë në vlerën 1.259.997 lekë. Në përgjigjen me shkresën nr. {***} prot., datë 12.07.2017, që ISSh i kthen kërkesës për informacion të Komisionit, konfirmon se shtetasi K.S. ka të ardhura nga paga neto si i punësuar pranë subjektit “K.S.”, me NIPT {***} prej muajit janar deri në dhjetor të vitit 2012 shumën 112.086 lekë, deri më 14.01.2013, 118.489 lekë.*

Nisur nga të dhënat e mësipërme, trupi gjykues ka dalë në përfundimin që shtetasi K.S. ka qenë në kushtet e pamundësisë financiare për të dhënë huan prej 30.000 eurosh bashkëshortit të subjektit, z. M.L.

Sa i takon pretendimit të ngritur në ankim se shtetasi K.S. ka pasur të ardhura të tjera si ato nga kontrata e qirasë, lidhur mes prindërve të tij M dhe E.S si qiradhënës dhe shoqërisë "E.I" ShA si qiramarrës, për një vlerë prej 5500 USD në muaj, në pikën 5 të kontratës parashikohet se pagesat e qirasë do të bëhen përmes bankës Raiffeisen ShA dhe do të vërtetohen me mandatpagesë bankare. Subjekti nuk provoi me dokumentacion këto pagesa të pretenduara prej tij dhe, për pasojë, ky pretendim mbetet në nivel deklarativ. Gjithashtu, nuk u paraqit asnjë provë nga subjekti i rivlerësimit për të provuar kalimin si të ardhura nga qiraja të shumës prej 30.000 eurosh, nga shoqëria "E.I" ShA te prindërit e huadhënësit si pretenduar, as nga prindërit te shtetasi K.S., në mënyrë që ky i fundit të kishte aftësinë financiare t'ia jepte hua më pas bashkëshortit të subjektit, z. M.L. . Gjithashtu, nga shqyrtimi i akteve në dosjen gjyqësore, trupi gjykues vëren se nuk ka të dhëna nga organet tatimore lidhur me pagesën e tatimeve për të ardhurat nga qiraja e pretenduar.

Huaja 12.000 euro nga A.L. nuk është deklaruar në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2009 nga subjekti apo personi i lidhur me të. Për herë të parë kjo hua prej 12.000 eurosh është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2013, si vijon: *Hua marrë vëllait të bashkëshortit (shih deklarimin e vitit 2012).*

Nuk është shlyer. Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer deri më 31.12.2013 është deklaruar në këtë deklaratë nga subjekti i rivlerësimit në vlerën 12.000 euro.

Për sa më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në vitin 2013, pasi subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar në vitet 2009-2012 asgjë lidhur me këtë hua. Gjithashtu, në procesverbalin e datës 20.12.2010, të mbajtur në ILDKPKI, referuar mungesës së burimeve financiare të ligjshme të pasurive të deklaruara për vitin 2009 në vlerën 2.182.254 lekë, subjekti i rivlerësimit është përgjigjur se kjo vlerë është mbuluar nga huaja e marrë vëllait të bashkëshortit, z. A.L., në datën 02.12.2009, siç pasqyrohet në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.12.2010, si dhe nga shitja e autoveturës me targa {***} në vlerën 450.000 lekë. Por nga shqyrtimi i deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.12.2010, të lëshuar nga z. A.L. për huan në shumën 12.000 euro, trupi gjykues konstaton se ajo është nënshkruar vetëm një ditë pas datës së procesverbalit në ILDKPKI, të mbajtur mes znj. Alma Liçaj dhe inspektorit të ILDKPKI-së, si dhe një vit pas dhënies së pretenduar të huas, gjë e cila i krijon bindjen trupit gjykues se ajo është lidhur me qëllim mbulimit me të ardhura të ligjshme të diferencës që ka rezultuar e pajustificuar nga kontrolli në ILDKPKI. Gjithashtu, nga shqyrtimi i akteve të dosjes gjyqësore, konstatohet se personi tjetër i lidhur, z. A.L., duke qenë dhe vetë subjekt deklarues² pranë ILDKPKI-së, nuk e ka deklaruar këtë hua në asnjë nga deklaramet e tij të interesave privatë/periodikë vjetorë të pasurisë.

*Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit në ankim se z. A.L. ka pasur mundësi financiare për të dhënë huan në shumën 12.000 euro, më datë 02.12.2009, nga trupi gjykues u verifikuan të ardhurat e huadhënësit A.L. nga burimet e pretenduara në ankim: 1) si administrator i shoqërisë "L" ShPK; dhe 2) nga 2109 m² sipërfaqe ndërtimore e përfutuar në cilësinë e bashkëpronarit të truallit në masën 15%, nga kontrata e investimit për ndërtim nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.04.2005, e përbërë nga dyqane, apartamente, njësi shërbimi, garazhe të cilat sipas subjektit, z. A.L. i ka tjetërsuar apo dhënë me qira, dhe nga të cilat ka përfutuar të ardhura të konsiderueshme.*

Lidhur me të ardhurat e pretenduara të z. A.L. nga shoqëria "L" ShPK, trupi gjykues ka konstatuar se, referuar të dhënave të ekstraktit historik, ortaku A.L. ka dhënë dorëheqjen më 21.09.2005 (me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nr. {***}, datë 21.09.2005) pasi i ka shitur kuotat shtetasit R.Gj. në vlerën 100.000 lekë (me vendimin nr. 1 të ortakut të vetëm të shoqërisë, datë 15.09.2005, dhe kontratë shitje kuotash të noterizuar, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.09.2005), i cili është emëruar administratori i ri i shoqërisë në këtë datë.

Referuar të njëjtit ekstrakt, është shtuar administratori A.L., nga data 15.05.2009 kur është larguar ish-administratori R.Gj, i cili i ka shitur 100% të kuotave të tij në vlerën 100.000 lekë.

² A.L. nga deklaramet e interesave privatë/periodikë vjetorë, të përcjella nga ILDKPKI-ja, rezultojnë të ketë qenë dhe vetë subjekt deklarues pranë këtij institucioni prej vitit 2013 e në vijim, për shkak të funksionit si drejtor i {***}.

Nga sa më sipër, në kundërshtim me sa pretendon subjekti në ankim, shtetasi A.L., për periudhën 21.09.2005-15.05.2009, nuk ka qenë as ortak dhe as administrator i shoqërisë “L” ShPK, ndërkohë që referuar të dhënave të DRT³ Vlorë, për vitin 2005, apo 2009 kur ai ka qenë për periudha të shkurtra kohore administrator i shoqërisë (01.01.2005 – 21.09.2005 dhe 15.05.2009 – 02.12.2009), si u verifikua nga trupi gjykues, nuk është deklaruar apo shpërndarë dividend.

Nga dokumentacioni i administruar nuk ka të dhëna lidhur me të ardhurat nga pagat e shtetasit A.L. deri më 02.12.2009. Të dhënat për të ardhurat nga pagat e këtij shtetasi, referuar shkresës nr. {***} prot., datë 12.07.2017, të ISSh Tiranë, fillojnë prej janarit 2012 e në vijim, ndërkohë që huaja i është dhënë prej tij personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. M.L., më 02.12.2009.

*Sa i takon pretendimit se A.L. ka përfituar sipërfaqe ndërtimore nga kontrata e investimit nr. {***} rep., nr. {***}, datë 15.04.2005, të cilat më pas i ka tjetërsuar apo dhënë me qira, trupi gjykues konstaton se, sipas provave që gjenden në dosjen e gjykimit, shtetasi A.L. ka përfituar vetëm në vitin 2015 nga kjo kontratë investimi dy njësi dhe një garazh përmes kontratës së dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.10.2015. Pra, z. A.L. nuk ka përfituar sipërfaqe ndërtimore të cilën më pas ta ketë shitur apo dhënë me qira në periudhën 2005-2009 nga ku të ketë përfituar të ardhura për të dhënë huan prej 12000 eurosh në vitin 2009, si pretendohet.*

Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Liçaj, në ankim se ajo e ka deklaruar rregullisht këtë hua që nga viti 2010, ky pretendim i saj nuk qëndron pasi, së pari, huaja në fjalë është deklaruar për herë të parë në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 20.12.2010 dhe jo në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë 2009 apo 2010, dhe së dyti, edhe pse e deklaruar në ILDKPKI në datën e mësipërme, përsëri huaja prej 12000 eurosh nuk rezulton të jetë deklaruar nga subjekti dhe personi i lidhur në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë të pasurisë, të bëra në vitet më pas, 2011 apo 2012.

Nuk qëndron gjithashtu pretendimi i subjektit të rivlerësimit se dokumenti ligjor prej ku fillon përgjegjësia e subjektit për shkelje administrative është deklarata e pasurisë *vetting*, pasi Kushtetuta nuk ka parashikuar në asnjë moment vlerën (primare) të deklaratës së pasurisë *vetting* apo të deklarimeve të pasurisë në vite. Nga interpretimi sistematik i dispozitave kushtetuese, rezulton se qëllimi i tyre nuk është të përcaktojnë rëndësinë e secilit prej deklarimeve, por verifikimi i saktë dhe i plotë i deklarimeve të subjektit, si dhe i burimeve të ligjshme të pasurisë, duke u dhënë të gjitha deklarimeve vlerën e provës.

Lidhur me diferencën në vlerën 25664 euro për pagesën e çmimit të apartamentit të përfituar si ulje, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në asnjë nga deklaratat periodike të pasurisë detyrimin financiar ndaj shoqërive sipërmarrëse e investitore, si dhe uljen e këtij detyrimi në përputhje me vlerën e situacioneve të punimeve të pretenduara se janë kryer nga vetë personi i lidhur në vitet përkatëse. Në këtë kuptim, nuk qëndron as pretendimi i ngritur nga

³ DRT – akronim për Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë.

subjekti në ankim se vlera e situacioneve të punimeve nuk është deklaruar në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë të pasurisë, pasi ajo ka qenë më e ulët se vlera e detyrueshme për t'u deklaruar sipas ligjit. Subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrim ligjor të deklarojë zvogëlimin e detyrimit financiar prej 25.664 eurosh të mbetur në vitin 2009, për çdo vit, për vlerën e rakorduar me situacionin e punimeve të pretenduara se janë kryer në vitin përkatës.

Lidhur me situacionet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për punime të pretenduara se janë kryer në vitet 2010, 2011 dhe 2012, e gjejmë të drejtë konstatimin e Komisionit se ato janë në kundërshtim me deklaratimet e bëra në procesverbalin e vitit 2014 të mbajtur në ILDKPKI, ku subjekti i rivlerësimit deklaroi ekzistencën e kështit të papaguar ndaj firmës ndërtuese në vlerën 25.664 euro, kështu i cili do të paguhej sipas deklaratimit në këtë procesverbal, kur të regjistrohej kjo pronë në hipotekë. Nëse do të ishte i vërtetë pretendimi i subjektit dhe personit të lidhur me të, për uljen e përfutur nga shoqëria ndërtuese për punimet e kryera nga vetë porositësi, kjo duhet të ishte reflektuar në deklaratimet e interesave privatë/periodikë vjetorë, të bëra deri në vitin 2014, si dhe në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në këtë vit, gjë e cila nuk ka ndodhur. I drejtë është konstatimi i Komisionit për situacionet e punimeve të pretenduara se janë kryer në vitin 2010, të paraqitura si provë nga subjekti për zbritje të përfutur në këtë vit, çka është në kundërshtim me deklaratimet e bëra në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 20.12.2010, ku subjekti i rivlerësimit deklaroi ekzistencën e kështit të papaguar ndaj shoqërisë ndërtuese, në vlerën 25.664 euro.

Të drejtë e vlerëson trupi gjykues konstatimin e Komisionit se përmbajtja e situacioneve të punimeve të paraqitura për vitet 2010, 2011, 2012 dhe 2015, është fiktive, pasi referuar këtyre situacioneve, rezultojnë që për vite të ndryshme të jenë kryer punime të njëjta, në të njëjtën sasi dhe të njëjtën vlerë.

Në mbështetje të këtij qëndrimi, trupi gjykues konstaton edhe faktin se, referuar nenit 7 të kontratës së sipërmarrjes mes personit të lidhur M.L. dhe shoqërive "A.C" ShPK dhe "B" ShPK si sipërmarrëse dhe investitore përkatësisht, nuk lejohet kryerja e punimeve nga të tretë, ndërkohë që subjekti ka pretenduar në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, datë 09.05.2018, se punimet në këtë apartament janë kryer pa shpërblim nga "L" ShPK, me nënkontraktor shoqërinë "{***}" ShPK.

Lidhur me pretendimin e ngritur në ankim për nënshkrimin e situacioneve, trupi gjykues vëren se situacionet e punimeve të pretenduara për vitet 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014 janë nënshkruar nga inxhinier J.V, ndërsa për vitet 2015 dhe 2016, situacionet e punimeve janë nënshkruar nga inxhinier L.D. Nga shqyrtimi i akteve në dosjen gjyqësore, në të gjendet vetëm një autorizim i shoqërisë "B" ShPK për ing. L.D. Megjithatë, në dallim nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se ky autorizim nuk është lëshuar edhe nga shoqëria tjetër "A.C" ShPK, për pasojë subjekti nuk ka paraqitur dokumentacionin ligjor të nevojshëm për tagrin e përfaqësimit të firmës investitore dhe sipërmarrëse. Në përfundim, situacionet janë nënshkruar dhe vulosur vetëm nga kompania investitore "B" ShPK, ndërkohë që kontrata e sipërmarrjes është e nënshkruar mes shoqërive "A.

C" ShPK e "B" ShPK në cilësinë e "sipërmarrësit" dhe "investitorit" përkatësisht nga njëra anë, dhe personit të lidhur, z. M.L., në cilësinë e "porositësit" nga ana tjetër.

Për gjithë sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se situacionet e paraqitura nga subjekti nuk janë të besueshme dhe për këtë arsye nuk mund të merren në konsideratë për të vërtetuar uljen e përfituar nga shoqëria.

Lidhur me diferencën e vlerës së apartamentit me shumën e paguar, të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit si ulje e përfituar nga shoqëria ndërtuese, për arsye të dorëzimit me vonesë të apartamentit në vitin 2016, trupi gjykues konstaton se në dosjen e gjykimit nuk gjendet dokument ligjor që të krijoj bindjen se dy shoqëritë "A.C." ShPK dhe "B" ShPK të kenë vendosur për uljen e kësaj vlere në marrëveshje mes palëve. Në dosjen gjyqësore gjendet vetëm kontrata e sipërmarrjes mes sipërmarrësit "A.C" ShPK, investitorit "B" ShPK nga njëra anë dhe porositësit, personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. M.L..

Gjithashtu, referuar kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.12.2009, në nenin 7 të saj parashikohet: "Sipërmarrësi detyrohet t'i dorëzojë porositësit brenda kohës prej 24 muajsh apartamentin të përfunduar [...]" dhe në nenin 8 të saj parashikohet: "Për mosrealizimin e ndërtimit të objektit brenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë, sipërmarrësi do të paguajë dëmshpërblim për çdo muaj vonesë në masën 0,1% të shumës së punimeve të përfunduara". Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë volumin e punimeve të përfunduara nga shoqëria sipërmarrëse, por të realizuara prej subjektit të rivlerësimit apo personit të lidhur me të.

30. Gjithë arsyetimi sa më sipër, u bazua në aktet administruara si vijojnë:

i. Kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.12.2009, me shoqërinë "A.C" ShPK dhe shoqërinë "B" ShPK për apartamentin 107,08 m².

ii. Kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.12.2008, për apartamentin 90,78 m², kontratë e prishur.

iii. Deklaratë noteriale mes shoqërive "B" ShPK., "A.C." ShPK dhe M.L. për prishjen e kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.12.2008, për apartament 90,78 m².

iv. Kontrata e huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.10.2008, me shtetasin A.M. në cilësinë e huadhënësit dhe z. M.L. në cilësinë e huamarrësit, për vlerën 60.000 euro, me afat 5 vjet, me interes vjetor 3%.

v. Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.12.2010, për huan në vlerën 12.000 euro nga vëllai A.L. për personin e lidhur M.L.

vi. Shkresë nr. {***} prot., datë 29.05.2018, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë për shtetasin A.L.

vii. Ekstrakt nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit për shoqërinë "L" ShPK.

viii. Situacion i punimeve për vitet 2010, 2011, 2012, 2013, 2014 dhe 2015, i nënshkruar nga inxhinierë të shoqërisë.

- ix. Vendim i ortakut të vetëm të shoqërisë "B" ShPK i datës 15.12.2016 për uljen e detyrimit në vlerën 9964 euro.
- x. Autorizim i Shoqërisë "B" ShPK për ing. L.D., i datës 15.10.2015.
- xi. Procesverbal dorëzim apartamenti i datës 20.12.2016.
- xii. Shkresë nr. {***} prot., datë 24.05.2018, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë për shtetasin A.M.
- xiii. Përgjigjet e pyetësorit të Komisionit nr. 2, datë 09.05.2018.
- xiv. Procesverbal i ILDKPKI-së, mbajtur mes inspektorit dhe subjektit të rivlerësimit më datë 20.12.2010.
- xv. Procesverbal i ILDKPKI-së, datë 15.09.2014.
- xvi. Kontrata e huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.01.2013, mes z. K.S. si huadhënës dhe z. M.L. si huamarrës, për vlerën 30.000 euro, me afat 3 vjet, me interes 3% në vit.
- xvii. Kontrata e qirasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.05.2009, me qiradhënës M dhe E.S. (prindër të z. K.S.), me qiramarrës "E.I" ShA për dhënien me qira të një objekti në vlerën 5500 dollarë amerikanë në muaj.
- xviii. Shkresë nr. {***} prot., datë 24.05.2018, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë për shtetasin K.S..
- xix. Shkresë nr. {***} prot., 16.03.2018, e Komisionit drejtuar të gjitha bankave për informacion mbi shtetasin A.M.

Në përfundim, për këtë pasuri, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se:

- *Subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë burimesh financiare për të justifikuar pasurinë, pasi nuk u provua me dokumentacion ligjor mundësia financiare e shtetasit A.M. për dhënien hua të shumës 60.000 euro dhe e shtetasit K.S. për dhënien hua të shumës 30.000 euro.*
 - *Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Liçaj, ka kryer deklaram të rremë lidhur me huan që bashkëshorti i saj pretendon se i ka marrë vëllait të tij, z. A.L., në shumën 12.000 euro.*
 - *Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë lidhur me vlerën e pretenduar si të papaguar në shumën 25.664 euro, shoqërisë ndërtuese për këtë apartament banimi, siç përcaktohet në nenin 33, pika 5, gerrat "a", "b" dhe "ç" të ligjit nr. 84/2016.*
31. Pasuria "apartament banimi, me sipërfaqe 100,68 m², Nr. {***} (2+1), ndodhur në katin e {***} dhe vendparkim me nr. {***}, ndodhur në rr. "{***}", Tiranë, në vlerën 60.000 euro".

Për këtë pasuri, Komisioni ka arritur në përfundimin se:

- i. *Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion ligjor provues mundësinë financiare të shtetasit L.S. për dhënien hua të shumës 70.000 euro.*
- ii. *Subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në posedim apo përdorim të tij.*
- iii. *Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit, sipas nenit D, paragrafi 5 i Aneksit të Kushtetutës.*

32. Trupi gjykues, lidhur me sa më sipër, konstaton se kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2016, sipas kontratës për kalim të drejtash reale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.07.2016, mes shtetasve P.Ç. e P.Z. dhe shoqërive "A. K." ShPK dhe "B" ShPK. Si burim krijimi për këtë pasuri subjekti ka deklaruar kontratën noteriale të huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.07.2016, të lidhur me huadhënësin, shtetasin L.S. për vlerën 70000 euro, me interes 3% në vit, me afat 5-vjeçar. Këtë burim krijimi, subjekti e ka deklaruar edhe në deklaratën e pasurisë *vetting* 2017.

*Referuar huas në vlerën 70000 euro, me deklaratën noteriale, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.11.2018, shtetasi L.S. konfirmon dhënien hua të shumës 70000 euro shtetasit M.L., sipas kontratës së huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.07.2016, me interes 3% në vit, afat 5-vjeçar likuidimi, duke deklaruar se ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e kësaj huaje nga shoqëria "L" ShPK, ku ka qenë ortak me 50 % të kuotave.*

Nga informacioni i vënë në dispozicion për periudhën 2008-2012 nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, subjekti tregtar "L" ShPK ka realizuar nga aktiviteti ekonomik për këto vite fitim total në vlerën 15169370 lekë. Për vitin 2013, shoqëria ka dalë me humbje në shumën 35738 lekë, ndërkohë që referuar ekstraktit historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit, shoqëria "L" ShPK rezulton të ketë kaluar në statusin "pezulluar" prej datës 25.03.2014. Referuar të njëjtës shkresë të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë, shoqëria "L" ShPK rezulton të mos ketë shpërndarë dividend për asnjë nga vitet në të cilat ka realizuar fitim. Për rrjedhojë, rezulton i pavërtetë deklarimi i shtetasit L.S. në deklaratën e tij noteriale, se të ardhurat për dhënien e huas në shumën 70000 euro i ka realizuar nga fitimi i shoqërisë "L" ShPK. Në vijim, trupi gjykues e gjen të pabazuar edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit se mosshpërndarja e dividendit mund të lidhet me avantazhet financiare që kanë ortakët për të shmangur pagimin e tatimit përkatës mbi dividendin, duke pasur parasysh faktin që, bazuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, të ardhura të ligjshme janë ato për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

*Lidhur me pretendimin e ngritur në ankim se nuk ka asnjë kontradiktë midis përmbajtjes së kontratës për kalim të drejtash reale dhe faktit se pagesa është bërë e menjëhershme, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime kontradiktore për sa i përket pagesës së vlerës së apartamentit, në total në shumën 60000 euro, sipas kontratës për kalim të drejtash reale dhe përgjigjeve të saj në pyetësonin nr. 2, datë 09.05.2018, të Komisionit. Kjo pasi në kontratën për kalim të drejtash reale, pagesa e çmimit është parashikuar si e kryer më parë me pjesë të ndryshme, ndërkohë që në përgjigjet e pyetësonit nr. 2 të Komisionit, datë 09.05.2018, subjekti deklaroi se shitësve u interesonte pagesa e menjëhershme *cash*. Në deklaratën noteriale të datës 31.10.2018, paraqitur si provë nga subjekti i rivlerësimit, shitësit e apartamentit, P.Ç. dhe P.Z., kanë deklaruar se pagesa është bërë në vitin 2016, duke qenë se ata kishin nevojë që kjo pagesë t'u bëhej në mënyrë të menjëhershme dhe *cash*.*

Gjithashtu, në të njëjtën linjë arsyetimi për pagesën me pjesë të çmimit të apartamentit, përveç kontratës për kalim të drejtash reale, në të cilën thuhet se *[për] vlerën e sipërcituar (çmimin), palët deklarojnë se është paguar me pjesë të ndryshme më parë [...]*, shkon edhe fakti që librezat e ujit dhe të energjisë elektrike janë hapur që në vitin 2014 në emër të shtetasit M.L.

Bazuar në provat e administruara për këtë pasuri, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë blerë të drejtat reale mbi këtë apartament, përfshirë verandën dhe vendparkimin në datën 25.07.2016, për 21922 euro më lirë sesa çmimi i përcaktuar i shitjes, shtetasve P.Ç. e P.Z., në kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.12.2009, në vlerën totale 81922 euro, nga e cila 65442 euro ka qenë vlera e apartamentit, 6480 euro vlera e verandës dhe 10000 euro vlera e vendparkimit.

Arsyetimi i subjektit se vlera e shitjes së apartamentit me sipërfaqe 100,68 m², verandës me sipërfaqe 16,20 m² dhe vendparkimit nr. {***}, është përcaktuar në marrëveshje mes palëve pasi shitësve u interesonte pagesa në *cash*, nuk u nevojitej më kjo pronë dhe kërkonin ta tjetërsonin atë, të ndikuar edhe nga vonesat në dorëzimin e apartamentit nga shoqëria ndërtuese, nuk është bindës, pasi referuar udhëzimit nr. 4, datë 30.09.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2015”, në tabelën nr. 3, “Të dhënat e tregut të lirë të apartamenteve në qytetin e Tiranës për vitin 2015”, çmimi referues për shitjen e apartamenteve në tregun e lirë, në qytetin e Tiranës, për vitin 2015, për zonën 9/1 e cila përfshin rrugën “{***}”, ka qenë në vlerën 130.000 lekë/m². Bazuar në sa më sipër, nga përlllogaritjet, çmimi i shitjes në tregun e lirë vetëm i apartamentit, pa verandën dhe vendparkimin, duhet të ishte në vlerën 13088400 lekë ose 95836 euro, e konvertuar me kursin mesatar të këmbimit të muajit korrik të vitit 2016, 136,57 lekë për njësi të monedhës euro, pra 35.836 euro më shumë se çmimi i blerjes nga personi i lidhur, z. M.L.. Kjo diferencë kaq e madhe mes çmimit në tregun e lirë dhe çmimit të shitjes në kontratë e bën argumentin e subjektit të rivlerësimit jobindës për trupin gjykues.

33. Gjithë sa më sipër, u bazua në aktet provuese si vijojnë:

i. Kontratë për kalim të drejtash reale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.07.2016, me shtetasit P.Ç. dhe P.Z, shoqërinë "A.C." ShPK dhe shoqërinë "B" ShPK në vlerën 60.000 euro.

ii. Kontrata e huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.07.2016, lidhur me shtetasin L.S. në cilësinë e huadhënësit dhe z. M.L. në cilësinë e huamarrësit, për vlerën 70000 euro, me afat 5 vjet, me interes 3% në vit.

iii. Përgjigjet e pyetësorit nr. 2, datë 09.05.2018, të Komisionit.

iv. Shkresë nr. {***} prot., datë 20.02.2018, e ZVRPP Tiranë, sipas së cilës në emër të subjektit dhe personave të lidhur nuk figurojnë pasuri.

v. Deklaratë noteriale e z. L.S. nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.11.2018.

vi. Ekstrakt nga Qendra Kombëtare e Biznesit për shoqërinë "L" ShPK.

vii. Shkresë nr. {***} prot., datë 24.05.2018, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë për shtetasin L.S. dhe shoqërinë "L" ShPK.

viii. Pasqyrat financiare të shoqërisë "L" ShPK për vitet 2008-2013.

ix. Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.10.2018 e shtetasve P.Ç. dhe P.Z.

Në përfundim, për këtë pasuri, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se:

◦ *Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, pasi ka mungesë burimi financiar të ligjshëm për të justifikuar pagesën e çmimit të apartamentit në vlerën 60.000 euro.*

◦ *Referuar nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave nga huaja, sipas nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016.*

34. Pasuria "apartament banimi, me sipërfaqe 71,8 m², Vlorë".

Për këtë pasuri, Komisioni ka arritur në përfundimin se *subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor, lidhur me mënyrën e fitimit të pronësisë apartament, me sipërfaqe 71,8 m², dhe nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie sipas nenit D, paragrafi 3 i Aneksit të Kushtetutës.*

35. Nga dokumentacioni i administruar në dosjen gjyqësore për këtë pasuri, trupi gjykues konstaton se, me shkresën nr. {***} prot., datë 28.02.2018, ZVRPP Vlorë konfirmon që në emër të personit të lidhur, z. M.L., rezulton ndër të tjera edhe pasuria apartament 71,8 m², me nr. {***}, ZK {***}, vol. {***}, f. {***}.

Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2003 nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. M.L., 100% në pronësi të tij. Ky deklaram i personit të lidhur është i njëjtë me deklaramin e bërë në deklaratën e pasurisë *vetting* 2017, në të cilën si burim krijimi deklarohet kontrata e shkëmbimit ndërmjet Ndërmarrjes Elektrike Vlorë dhe personit të lidhur të subjektit, z. M.L.

Nga shqyrtimi i akteve të dosjes gjyqësore, rezulton që, nga ZVRPP Vlorë t'i jetë dërguar në përgjigje të kërkesës për informacion Komisionit dosja përkatëse e kësaj pasurie, pjesë e së cilës është vetëm aktmarrëveshja e shkëmbimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.07.2000, mes shtetasit M.L. dhe "ShA E.V", përfaqësuar nga drejtori H.Gj, si dhe një vërtetim nga dokumentet hipotekore, i datës 18.07.2000, sipas të cilit në pronësi të personit të lidhur M.L. është pasuria nr. {***}, objekt garazh me dimensione 5 x 5 m, me sipërfaqe 25 m², ndodhur në ZK {***}, në lagjen "{***}", Vlorë.

Nisur nga sa më sipër, trupi gjykues konstaton që në dosjen e dërguar nga ZVRPP Vlorë, nuk ka dokumentacion që të vërtetojë origjinën e pronës së "ShA E.V", "kabinë nr. {***}, pallati nr. {***}", në mënyrë që më pas ndërmarrja elektrike ta shkëmbente këtë pasuri me garazhin me

sipërfaqe 25 m², ky i fundit në pronësi të personit të lidhur, z. M.L. Gjithashtu, në këtë aktmarrëveshje nuk kuptohet sa ka qenë sipërfaqja e kabinës nr. {***}. Nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk u provua se si dhe me çfarë burimi të ardhurash është përfituar pasuria nr. {***}, objekt garazh me dimensione 5 x 5 m, me sipërfaqe 25 m², ndodhur në ZK {***}, në lagjen "{***}", Vlorë, në mënyrë që më pas të shkëmbej kjo pasuri me pasurinë e "ShA E.V".

Për pretendimin se pasuria në fjalë është përfituar përpara lidhjes së martesës, si e tillë nuk është rrjedhojë e ushtrimit të detyrës si gjyqtare dhe, për pasojë, nuk duhet t'i nënshtrohet kontrollit, trupi gjykues vlerëson se sipas nenit Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, rivlerësimi i subjekteve për kriterin e pasurisë kryhet nga institucionet e rivlerësimit, në përputhje me parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe Kreut IV të ligjit nr. 84/2016. Sipas përkufizimit të nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, me pasuri kuptojmë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit.

Në këtë kuptim, çdo pasuri që është deklaruar dhe është në pronësi, posedim apo përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur me të, në momentin e deklarimit, i nënshtrohet kontrollit të plotë mbi vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimit, si dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit. Gjithashtu, referuar certifikatës për vërtetim pronësie nr. {***}, datë 30.05.2012, dhe kartelës së pasurisë së paluajtshme bashkëlidhur saj, të sjella si provë nga subjekti i rivlerësimit, pasuria e mësipërme figuron të jetë regjistruar në ZVRPP Vlorë më datë 23.04.2012, pra gjatë martesës së subjektit me shtetasin M.L., duke e bërë në këtë mënyrë të pavërtetë deklarimin e subjektit të rivlerësimit se ajo është regjistruar përpara martesë në ZVRPP Vlorë.

36. Gjithë sa më sipër, u bazua në aktet provuese si vijojnë:

i. Shkresë nr. {***} prot., datë 28.02.2018 e ZVRPP Vlorë, sipas së cilës në emër të z. M.L. rezulton pasuri e llojit apartament, me sipërfaqe 71,8 m², në Vlorë.

ii. Aktmarrëveshje për shkëmbim pasurie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.07.2000, (depozituar nga subjekti në ILDKPKI), me palë H.Gj në cilësinë e drejtorit të ndërmarrjes "ShA E.V", si disponuese e kabinës elektrike nr. {***}, në pallatin {***}, dhe z. M.L. në cilësinë e pronarit të pasurisë "Objekt ndërtimor 1-katësh", me lartësi 4 metra, sipas vërtetimit hipotekor të datë 18.07.2007.

iii. Certifikatë për vërtetim pronësie nr. {***}, datë 30.05.2012, dhe kartelë e pasurisë së paluajtshme.

Në përfundim, për këtë pasuri, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se *subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë "apartament banimi me sipërfaqe 71,8 m², Vlorë", sipas nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016.*

37. Pasuria "ndërtesë me sipërfaqe 120 m² dhe truall 215 m², Vlorë".

Për këtë pasuri, Komisioni ka arritur në përfundimin se:

i. *Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion ligjor provues pronësinë mbi ndërtesën me sipërfaqe 120 m², si dhe truallin funksional në përdorim të banesës me sipërfaqe 215 m².*

ii. *Nga hetimi ka rezultuar se posedimi i kësaj ndërtese dhe truallit të saj nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të subjektit, është i paligjshëm.*

iii. *Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit sipas nenit D, paragrafi 5 i Aneksit të Kushtetutës.*

38. Nga dokumentacioni i administruar në dosjen gjyqësore për këtë pasuri, trupi gjykues konstaton se me shkresën nr. {***} prot., datë 28.02.2018, ZVRPP Vlorë konfirmon se në emër të personit të lidhur, z. M.L., rezultojnë ndër të tjera edhe pasuria ndërtesë 120 m², me nr. {***}, ZK {***}, vol. {***}, f. {***}.

Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2003 nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. M.L., 100% në pronësi të tij, si banesë 3-katëshe, me sipërfaqe 300 m², me vlerë 5.000.000 lekë, ndodhur në lagjen “{***}”, me nr. regjistri hipotekor {***}, datë 03.10.2001, me burim nga kursimet dhe pjesë takuese e personit të lidhur 100%.

Në deklaratën e pasurisë *vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në pronësi të bashkëshortit ndërtesë me sipërfaqe 120 m², si dhe truall funksional me sipërfaqe 215 m², me nr. pasurie {***}, e regjistruar në vol. {***}, f. {***}, e ndodhur në ZK {***}, pasuri e krijuar sipas lejes së ndërtimit nr. {***}, datë 16.08.1991, e Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Qytetit. Vlera nuk është përcaktuar, ndërsa pjesa takuese 100%.

Lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues konstaton së pari, se ka mospërputhje mes deklaramit të vitit 2003 ku deklarohet banesë 3-katëshe me sipërfaqe 300 m², me vlerë 5.000.000 lekë, vlerë për të cilën nuk ka deklaruar në asnjë moment burimin e ligjshëm dhe deklaratës së pasurisë *vetting* 2017, në të cilën nuk deklarohet vlera e banesës, ndërkohë që sipërfaqja e saj (ndërtesë me sipërfaqe 120 m², si dhe truall funksional me sipërfaqe 215 m² sipas deklaratës *vetting*) është e ndryshme nga ajo e deklaruar në vitin 2003. Nga sa rezultoi nga dokumentet ligjore dhe financiare, të depozituara nga subjekti i rivlerësimit për justifikimin e pasurisë, trupi gjykues arrin në përfundimin se personi i lidhur i subjektit të rivlerësimit nuk kishte të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për të ndërtuar shtëpinë në vlerën 5.000.000 lekë.

Nga shqyrtimi i akteve të dosjes gjyqësore, rezultojnë se vendimi i Komitetit Ekzekutiv Pluralist i Qytetit Vlorë "Për dhënie leje ndërtimi qytetarëve", me nr. {***}, datë 16.08.1991, është deklaruar i falsifikuar me vendimin nr. {***}, datë 31.05.2008, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së

Parë Vlorë. Ky vendim i prokurorisë i është bërë me dije personit të lidhur, z. M.L., me shkresën nr. {***} prot., datë 09.02.2017, të Arkivit Shtetëror Vendor Vlorë.

Ndërkohë që dokumenti i lëshuar nga Komitetit Ekzekutiv KP Qytetit, "Leje ndërtimi e meremetimi nr. {***}, datë 16.8.1991", është deklaruar i falsifikuar me vendimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, të datës 04.01.2018, por sipas vërtetimit të së njëjtës prokurori më datë 01.11.2018, kjo e fundit bën me dije se, *referuar kallëzimit të Arkivit Shtetëror Vendor, Vlorë për shpalljen të falsifikuar të lejes së ndërtimit në emër të shtetasit M.L., më datë 09.01.2018, i është dërguar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, kërkesa për pushimin e hetimeve. Kjo gjykatë, me vendimin nr. {***}, datë 19.02.2018, vendim i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 17.05.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë, ka vendosur kthimin e akteve në Prokurori për vazhdimin e hetimeve sipas detyrave përkatëse.*

Për sa më sipër, meqenëse vendimi nr. {***}, datë 16.08.1991, "Për dhënie leje ndërtimi qytetarëve", është deklaruar i falsifikuar me vendimin nr. {***}, datë 31.05.2008, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë dhe referuar urdhrit nr. {***}, datë 05.02.2018, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, me të cilin urdhërohet heqja nga shërbimi dhe shënimi "i falsifikuar" i dokumenteve të sipërcituara, sipas njoftimit dhe vendimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, për pasojë posedimi i kësaj ndërtese dhe truallit të saj nga ana e subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Liçaj, dhe bashkëshortit të saj është i paligjshëm.

Në këtë kuptim, nuk qëndron as pretendimi i ngritur në ankim nga subjekti i rivlerësimit se procedimi penal lidhur me falsitetin e lejes është ende në proces hetimi paraprak, pasi ky pretendim lidhet me ekzistencën ose jo të elementeve të veprës penale të dyshuar se është kryer nga bashkëshorti, por jo për ligjshmërinë e aktit në fjalë.

Për pretendimin e ngritur në ankim se lidhur me ligjshmërinë e posedimit të truallit, Kolegji duhet t'i referohet nenit 169 të Kodit Civil për parashkrimin fitues pa titull, trupi gjykues çmon se Kolegji nuk ka kompetencë të gjykojë njohjen e subjektit si pronar përmes kësaj dispozite të Kodit të Civil.

Gjithashtu, nga verifikimi i bërë në terren nga ALUIZNI Vlorë, rezulton se objekti ndërtesë (4 kate) është ndërtuar në një sipërfaqe publike dhe mbi një vendstrehim, ku ky i fundit përbën pronë të paluajtshme publike, bazuar në nenin 3, pika 1, shkronja "c" e ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", i ndryshuar, duke qenë se për nga natyra është një objekt i destinuar për qëllime të sigurisë publike, e si i tillë është pronë publike e patjetërsueshme në kuptim të nenit 168, paragrafi 3 i Kodit Civil. Bazuar në nenin 4 të ligjit si më sipërpërmendur, pronat e paluajtshme publike tjetërsohen ose jepen në përdorim vetëm sipas mënyrave dhe kufijve të përcaktuar me ligje të veçanta, gjë e cila nuk rezulton nga aktet në dosjen gjyqësore.

Lidhur me pretendimin në ankim se, nëse leja deklarohet e falsifikuar, ndërtimi i paligjshëm nuk përbënte veprë penale sipas ligjit të kohës, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk mund të

merret në konsideratë, duke qenë se kualifikimi i veprave penale është fushë veprimi e organeve kompetente të procedimit.

Lidhur me pretendimin e ngritur në ankim se kjo pasuri është e bashkëshortit që përpara lidhjes së martesës, trupi gjykues vlerëson se sipas nenit Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, rivlerësimi i subjekteve për kriterin pasurisë kryhet nga institucionet e rivlerësimit, në përputhje me parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe Kreut IV të ligjit nr. 84/2016. Sipas përkufizimit të nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, me pasuri kuptojmë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit.

Në këtë kuptim, çdo pasuri që është deklaruar dhe është në pronësi, posedim apo përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur me të, në momentin e deklarimit, i nënshtrohet kontrollit të plotë mbi vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimit, si dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit. Për sa më sipër, nuk qëndron ky pretendim i ankuesit.

39. Gjithë sa më sipër, u bazua në aktet provuese si vijojnë:

i. Shkresë nr. {***} prot., datë 28.02.2018, e ZVRPP Vlorë, sipas së cilës z. M.L. rezulton të ketë në pronësi pasurinë ndërtesë me sipërfaqe 120 m².

ii. Certifikatë pronësie nr. {***}, datë 30.05.2012, për ndërtesë me nr. pasurie {***}, me sipërfaqe 120 m².

iii. Vendim i Gjykatës së Rrethit Vlorë nr. {***} vendimi, datë 28.07.1994, për njohje pronar të z. M.L. për objektin në lagjen “{***}”, i ndërtuar sipas lejes së ndërtimit nga organet e pushtetit të datës 10.03.1993.

iv. Vendim i Gjykatës së Rrethit Vlorë nr. {***}, datë 30.01.1996, me objekt detyrim njohje pronar mbi një objekt në lagjen “{***}”.

v. Vërtetim pronësie i datës 18.08.1994, i Hipotekës Vlorë, me anë të të cilit vërtetohet se në pronësi të z. M.L. gjendet e regjistruar pasuria shtëpi me nr. {***}, në lagjen “{***}”, e përbërë nga tri dhoma, një kuzhinë, korridor, verandë.

vi. Vërtetim pronësie nr. {***}, datë 14.02.1996, i Hipotekës Vlorë, me anë të të cilit vërtetohet se në pronësi të z. M.L. u regjistrua pasuria banesë 2-katëshe, me katër dhoma, dy banjo, korridor, verandë, garazh e bodrum, me sipërfaqe 304 m², ndodhur në lagjen “{***}”, Vlorë.

vii. Shkresë nr. {***} prot., datë 28.05.2018, e ALUIZNI-t Vlorë, me anë të së cilës janë dërguar:

a) kërkesë e personit të lidhur, z. M.L., e datës 18.12.2007;

b) procesverbal i verifikimit në terren i datës 19.12.2007;

c) skicat e 4 kateve.

Në këtë shkresë specifikohet se leja e ndërtimit nr. {***}, datë 16.08.1991, nuk ka shërbyer për ndërtimin e këtij objekti, pasi ajo ka qenë e falsifikuar.

- viii. Përgjigjet e pyetësorit nr. 2, datë 09.05.2018, të Komisionit.
 - ix. Vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. {***}, datë 03.10.2001.
 - x. Vendim i Komitetit Ekzekutiv Pluralist i Qytetit Vlorë "Për dhënie leje ndërtimi qytetarëve", me nr. {***}, datë 16.8.1991.
 - xi. "Leje ndërtimi e meremetimi nr. {***}", datë 16.8.1991, e Komitetit Ekzekutiv KP Qytetit, sjellë nga ZVRPP Vlorë.
 - i. "Leje ndërtimi e meremetimi nr. {***}", datë 16.8.1991, e Komitetit Ekzekutiv KP Qytetit, sjellë nga subjekti i rivlerësimit.
 - xii. Shkresë nr. {***} prot., datë 09.02.2017, e Arkivit Shtetëror Vendor Vlorë, sipas së cilës leja e ndërtimit nr. {***} është shpallur e falsifikuar e për këtë nuk mund të shërbehet (drejtuar z. M.L.).
 - xiii. Vërtetim i datës 01.11.2018, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, lidhur me fazën në të cilën ndodhet procedimi penal nr. {***}, për hetimin dhe shpalljen si të falsifikuar të vendimit të Komitetit Ekzekutiv Pluralist të Qytetit nr. {***}, për dhënie leje ndërtimi.
 - xiv. Njoftim për përfundimin e hetimeve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, i datës 04.01.2018, në lidhje me procedimin penal nr. {***}, datë 17.03.2017, me kallëzues Arkivin Shtetëror Vendor, Vlorë, regjistruar për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.
- Vërtetim i datës 08.09.2001, i Arkivit Shtetëror të Rrethit Vlorë, ku konfirmohet ekzistenca e lejes së ndërtimit nr. {***}, në dosjen nr. {***}, të vitit 1991, me nr. rendor {***}, në fondin e institucionit të Komitetit Ekzekutiv Pluralist të Qytetit.

Në përfundim, për këtë pasuri, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se *subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, pasi nuk provoi me dokumentacion justifikues burimet e ligjshme për të krijuar pasurinë, siç përcaktohet në nenin 33, pika 5, gerमत "a" dhe "b" të ligjit nr. 84/2016.*

- 40. Pasuria "njësi me sipërfaqe 43 m², njësi me sipërfaqe 95 m² dhe garazh me sipërfaqe 35 m², ndodhur në rr. "{***}", Vlorë".

Për këtë pasuri, Komisioni ka arritur në përfundimin se:

- i. *Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë lidhur me dhurimin e bërë nga ana e shtetasit A.L., kundrejt shtetasit M.L., për pasuritë njësi me sipërfaqe 43 m², njësi me sipërfaqe 95 m² dhe garazh me sipërfaqe 35 m².*
- ii. *Subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim apo përdorim të tij.*
- iii. *Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit sipas nenit D, paragrafi 5 i Aneksit të Kushtetutës.*

- 41. Lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se këto pasuri janë deklaruar për herë të parë në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2016, si pasuri të fituara me kontratën e dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.02.2016, dhuruar bashkëshortit të

subjektit të rivlerësimit nga vëllai i tij, z. A.L.

Në lidhje me këto pasuri, nga subjekti i rivlerësimit u sollën së bashku me ankimin edhe dy aktet e mëposhtme, si dhe kërkesa për marrjen në shqyrtim të tyre:

◦ Aktmarrëveshje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.07.2006, lidhur ndërmjet shoqërisë "{***}" ShPK, shoqërisë "A" ShPK dhe shoqërisë "L" ShPK; dhe

◦ Kontratë investimi me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.04.2005, lidhur midis pronarëve të truallit, dhe palë investitore A.L., A.Z. dhe A.M. (ku personat që shfaqen si palë investitore janë edhe bashkëpronarë trualli në përqindje të ndryshme sipas përcaktimeve në kontratë).

42. Këto akte nuk janë paraqitur gjatë hetimit administrativ në Komision, për të provuar në këtë mënyrë, me dokumentacion ligjor, mënyrën dhe arsyet e fitimit të pronësisë mbi këto pasuri nga personi tjetër i lidhur, z. A.L., për t'u transferuar më pas te personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. M.L., përmes dhurimit. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi arsyen e mosparaqitjes së këtyre akteve në Komision dhe, sipas nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, me vendim të ndërmjetëm të trupit gjykues, aktet e mësipërme nuk u pranuan të merren si provë gjatë gjykimin të çështjes në Kolegj.
43. Për pasuritë më sipër, të përbëra nga një garazh dhe dy njësi shërbimi në rrugën "{***}" Vlorë, me sipërfaqe totale 173 m², trupi gjykues pas një vlerësimi tërësor dhe individual të akteve shpresore dhe të shpjegimeve të dhëna prej subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, parë në kontekstin e detyrimit për barrën e provës sipas nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, vlerëson se edhe pas kalimit të barrës së provës për të hedhur dritë mbi rrethanat që çuan në fitimin e kësaj pronësie nga bashkëshorti, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të sillte dokumente provuese të cilat të bindnin trupin gjykues për të kundërtën. Mbeti e pashpjeguar bindshëm dhe provuar me dokumentacion prej subjektit të rivlerësimit mënyra se si personi tjetër i lidhur, z. A.L., vëllai i bashkëshortit të subjektit, fitoi pronësinë mbi atë sipërfaqe trualli dhe se si kjo marrëdhënie biznesi e tij me pronarët e tjerë dhe bashkinvestuesit prodhoi si rezultat një dhurim prej 173 m², ndërkohë që shoqëria "L" ShPK rezultonte me mungesë likuiditetesh, pasi mbi titujt e pronësisë së saj ishte vendosur barrë sigurie sipas urdhrin nr. {***} prot., datë 19.02.2016, të Bashkisë Vlorë, Drejtoria e Menaxhimit Financiar, për shkak të mosshlyerjes së detyrimeve tatimore.
44. Këtë vlerësim, trupi gjykues e mbështet edhe në faktin e konstatuar nga Komisioni se z. A.L., megjithëse edhe vetë subjekt deklarues sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, nuk rezulton të ketë deklaruar këtë dhurim në deklaratimet e tij periodike të pasurisë. Në zbatim të kërkesave të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur, përfshirë edhe dhuruesit, duhet të justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Në funksion dhe zbatim të kësaj dispozite, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte paraqitur dokumentacion shterues që qartësonte hapat e fitimit të pronësisë nga personi tjetër i lidhur, z. A.L., deri në fitimin e pronësisë nga personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. M.L. Trupi gjykues vëren

edhe se subjekti nuk duket të ketë qenë në situatën e pamundësisë objektive të parashikuar në nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi në asnjë çast gjatë hetimit administrativ apo seancën publike në Komision, si dhe në ankim, nuk rezulton të jetë ngritur pamundësia objektive si shkak për mungesën e dokumentacionit provues.

45. *Për pretendimin e ngritur në ankim se Komisioni ka gabuar kur ka arritur në përfundimin se z. A.L. ka përfituar vetëm pasuritë që i ka dhuruar vëllait nga ky ndërtim, pasi ka përfituar rreth 2109 m² sipërfaqe të tjera ndërtimore, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti prova të tjera mbështetëse lidhur me këtë pretendim, si kontratën e ndarjes së pjesëve takuese etj. Për këtë arsye, nuk qëndron ky pretendim i ankuesit.*
46. Gjithë sa më sipër, u bazua në aktet provuese si vijojnë:
- i. Shkresë nr. {***} prot., datë 28.02.2018, e ZVRPP Vlorë, sipas së cilës z. M.L. ka në pronësi njësi me sipërfaqe 43 m², njësi me sipërfaqe 95 m² dhe garazh me sipërfaqe 35 m², ndodhur në rr. "{***}", Vlorë.
 - ii. Leje ndërtimi nr. {***}, datë 27.07.2005, për kompleks godinash në lagjen "{***}" Vlorë, për shoqëritë "A" ShPK, "L" ShPK dhe "{***}" ShPK.
 - iii. Vendim i KRRt Vlorë nr. {***}, datë 19.04.2005, për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit.
 - iv. Vendim i kryetarit të Bashkisë Vlorë nr. {***}, datë 26.08.2014, për saktësimin e planimetrisë së sheshit të ndërtimit.
 - v. Leje ndërtimi e KRRt Vlorë (e saktësuar) nr. {***}, datë 26.08.2014, për shoqëritë "A" ShPK, "L" ShPK dhe "{***}" ShPK.
 - vi. Leje përdorimi e Bashkisë Vlorë nr. {***}, datë 29.09.2014.
 - vii. Kontratë dhurimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.02.2016, me dhurues A.L. dhe pranues të dhurimit M.L.
 - viii. Kontratë dhurimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.10.2015, me palë dhuruese shoqërinë "L" ShPK, me administrator A.L., shoqërinë "{***}" SHPK, me administrator A.Z., dhe shoqërinë "A" ShPK me administratore, znj. F.M, dhe palën pranuese të dhurimit, z. A.L.
 - ix. Certifikata për vërtetim pronësie nr. {***}, datë 09.11.2015, nr. {***}, datë 09.11.2015, nr. {***}, datë 09.11.2015.
 - x. Shkresë e ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 27.03.2018, me anë të së cilës janë vënë në dispozicion deklaratimet periodike të pasurisë për shtetasin A.L.
 - xi. Përgjigjet e pyetësorit nr. 2, datë 09.05.2018, të Komisionit.
 - xii. Vërtetim i 3 shoqërive, "{***}" ShPK, "A" ShPK dhe "L" ShPK, për kalimin e 2 njësive dhe një garazhi shtetasit A.L., si kalim i të drejtave të tij mbi pjesët takuese të bashkëpronësisë, si administrator i shoqërisë "L" ShPK, bazuar në kontratën e investimit dhe bashkëpunimit midis tri shoqërive.

Në përfundim, për këtë pasuri, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se *subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë, sipas nenit "D", pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.*

47. Pasuria "automjet, tip Mercedes Benz, vit prodhimi 1993, me targa {***}".

Për këtë pasuri, Komisioni ka arritur në përfundimin se *shitja e autoveturës, tip "Mercedes Benz", vit prodhimi 1993, me çmim 4 herë më shumë se ai i blerjes nga ana shitësit, në të vërtetë përbën një veprim financiar të pajustificuar.*

48. Lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues konstaton se, në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2003, bashkëshorti i subjekti të rivlerësimit ka deklaruar në pronësi automjetin tip "Benz", me targë {***}, viti i prodhimit 1993, me vlerë 500.000 lekë, blerë me të ardhura nga aktiviteti privat. Pjesa që zotëron 100 %.

Në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Shitje e automjetit me targë {***}, shtetasit N.H., sipas kontratës noteriale të shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.05.2013, notere L.C., në vlerën 15.000 euro (gjendje cash në shtëpi). Pjesa takuese: 50%.*

Për sa më sipër, trupi gjykues konstaton se në momentin e blerjes së automjetit nga personi i lidhur, z. M.L., automjeti ka qenë rreth 10 vite në qarkullim, ndërkohë që është shitur nga personi i lidhur në një vlerë rreth 4 herë më të lartë se çmimi i blerjes, pasi kishin kaluar afro 10 vite të tjera nga momenti i blerjes dhe tashmë makina ishte 20-vjeçare. Referuar pretendimeve të tij, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë shpenzimet për mirëmbajtje dhe përmirësim të kryera nga personi i lidhur për këtë mjet, të cilat kanë sjellë rritjen e vlerës së tij. Për këtë arsye, çmimi i referuar në kontratën e shitjes, si dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk i krijojnë bindjen trupit gjykues për vlerën reale të shitjes.

Referuar ligjit të kohës nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë nuk është përcjellë informacion lidhur me pagesën e ndonjë tatimi mbi këtë shitje dhe as një deklaratë e të ardhurave personale të subjektit, duke qenë se e ardhura kalon vlerën 2.000.000 lekë dhe për këtë do të duhej të plotësohej deklarata individuale vjetore e të ardhurave, bazuar edhe në udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006, të Ministrit të Financave "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Nisur nga sa më sipër, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë paguar tatim fitimi lidhur me këtë shitje, nga e cila rezulton një e ardhur rreth 2.114.000 lekë (15.000 euro) apo një fitim prej 1.614.000 lekësh, si diferencë mes çmimit të blerjes prej 500.000 lekësh në vitin 2002 dhe çmimit të shitjes prej 2.114.000 lekësh në vitin 2013.

49. Gjithë sa më sipër, u bazua në aktet provuese si vijojnë:
- i. Shkresë nr. {***} prot., datë 18.04.2018, e DPSHTRr, me anë të së cilës është dërguar dosja e mjetit me targë {***}, ndryshuar në targat {***}.
 - ii. Kontratë blerjeje automjeti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.10.2002, me shitës A.G. dhe blerës M.L., në vlerën 500.000 lekë.
 - iii. Kontratë shitjeje automjeti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.05.2013, me anë të së cilës shitet automjeti në vlerën 15.000 euro, me shitës M.L. dhe blerës N.H.
 - iv. Përgjigjet e pyetësorit nr. 2, datë 09.05.2018, të Komisionit.

Në përfundim, për këtë pasuri, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se për pasurinë "automjet, tip Mercedes Benz, viti i prodhimit 1993, me targa {***}", subjekti i rivlerësimit me veprimet e tij ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi çmimi i referuar në kontratën e shitjes, si dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk i krijojnë bindjen trupit gjykues për vlerën reale të shitjes.

50. Pasuria "automjet, tip Mercedes Benz, me targë {***}".

Për këtë pasuri, Komisioni ka arritur në përfundimin se shitja e autoveurës, tip "Mercedes Benz", i vitit 2000, me çmim 4 herë më shumë se ai i blerjes nga ana shitësit, në të vërtetë përbën një veprim financiar të pajustificuar, ndërsa ekzistenca e dy kontratave të shitjes për të njëjtin automjet me të njëjtin çmim përbën një veprim fiktiv me qëllim për të mbuluar shlyerjen e huas.

51. Lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues konstaton se në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2009, personi i lidhur, z. M.L., deklaron: blerje e autoveurës, Mercedes Benz, me nr. shasië {***}, me targë {***}, me kontratë shitjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.08.2009, në vlerën 600.000 lekë. Pjesa që zotëron: 100%.

Në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2010, personi i lidhur, z. M.L. deklaron: Shitje e autoveurës, marka Mercedes Benz, me nr. shasië {***}, me targë {***}, me kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.08.2010, në vlerën 20000 euro. Pjesa që zotëron: 100%.

Trupi gjykues konstaton se në dosjen e dërguar nga DPSHTRr-ja, për këtë shitje është depozituar kontrata noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.06.2010, përpara noterës Sh.Gj., me shitës M.L. dhe blerës K.S., me çmim 20000 euro. Kjo kontratë është e ndryshme nga kontrata që gjendet në dosjen e ILDKPKI-së, depozituar nga vetë subjekti, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.08.2010, përpara noterës L.C., me shitës M.L. dhe blerës K.S. Duke qenë se për të njëjtin pasuri janë nënshkruar dy kontrata shitjeje mes të njëjtave palë, si shitës dhe blerës, me të njëjtin çmim, por në data të ndryshme dhe para noterëve të ndryshëm, trupi gjykues vlerëson se në këtë rast kemi të bëjmë me veprime juridike fiktive, për pasojë subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

Gjithashtu, nga aktet e gjendura në dosje, konkretisht e-mail-i i dërguar nga DPSHTRr rezulton që ky mjet të ketë qenë i vjedhur. Neni 141/a i Kodit Penal parashikon: *Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi në kundërshtim me ligjin, i mjeteve motorike të vjedhura, me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet.*

Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit në ankim se çmimi i blerjes së automjetit të mësipërm në vlerën 600.000 lekë, është për shkak të faktit se pasi është blerë nga personi i lidhur, z. M.L., ka rezultuar i vjedhur dhe, për rrjedhojë, justifikohet plotësisht çmimi i ulët i blerjes së tij, trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit si më sipër, krijojnë dyshime për figurën e gjyqtares, pasi nuk janë bindëse.

Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues krijon bindjen se kjo kontratë është bërë në dukje me qëllim që shuma 20.000 euro, e përfituar nga shitja e autoveurës, të përdorej për blerjen në datën 12.10.2010 të autoveurës Mercedes Benz 270 CC, me targë italiane {***}, në vlerën 4500 euro plus vlerën doganore 481.826 lekë, për të krijuar gjendje 10.000 euro si rrjedhojë e diferencës së çmimit të shitjes së automjetit sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.08.2000, si dhe për shlyerjen e një pjese të huas së marrë në shumën totale 60.000 euro nga shtetasi A. M.

Nga shqyrtimi i akteve që gjenden në dosjen e gjykimit, nuk rezulton që për këtë shitje subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur të kenë paguar tatim fitimi për të ardhurën rreth 2.755.000 lekë (20.000 euro) të realizuar nga shitja e autoveurës së mësipërme, apo për fitimin prej 2.155.000 lekësh si diferencë e çmimit të blerjes, 600.000 lekë, në vitin 2009 dhe çmimit të shitjes, 2.755.000 lekë (20.000 euro), në vitin 2010. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë nuk ka përcjellë asnjë informacion lidhur me pagesën e ndonjë tatimi mbi këtë shitje. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë shpenzimet e bëra nga personi i lidhur për rritjen e vlerës së automjetit, në mënyrë që më pas ta shiste për një vlerë rreth 4 herë më të lartë se çmimi i blerjes së tij.

52. Gjithë sa më sipër, u bazua në aktet provuese si vijojnë:

- i. Kontratë shitblerjeje automjeti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.08.2009, në vlerën 600.000 lekë.
- ii. Kontratë shitblerjeje automjeti me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.08.2010, para noteres L. C, me shitës M.L. dhe blerës K.S., për çmimin 20.000 euro.
- iii. Kontratë shitblerjeje automjeti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.06.2010, para noteres Sh.G, me shitës M.L. dhe blerës K.S., për çmimin 20.000 euro.
- iv. Certifikatë pronësie e mjetit në favor të z. G.Sh.
- v. Pagesë e taksës doganore të mjetit në vlerën 784.783 lekë.
- vi. Urdhër bllokimi dhe *e-mail* që mjeti rezulton i vjedhur.
- vii. Konfirmim i noteres Sh.Gj., datë 01.11.2008.
- viii. Përgjigjet e pyetësorit nr. 2, datë 09.05.2018, të Komisionit.

Në përfundim, për këtë pasuri, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se *për pasurinë "autoveurë, tip Mercedes Benz, me targë {***}", subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime fiktive për shitjen e tij nëpërmjet dy kontratave të shitjes për të njëjtin automjet, ka kryer deklaram të rremë, sipas nenit 33, pika 5, germa "ç" e ligjit nr. 84/2016 dhe ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi çmimi i referuar në kontratën e shitjes, si dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk i krijojnë bindjen trupit gjykues për vlerën reale të shitjes.*

53. Pasuria "autoveurë, tip Mercedes Benz, me targë {***}."

Për këtë pasuri, Komisioni ka arritur në përfundimin se *mjeti, me të gjithë parametrat e përmendur në kontratë, varion me çmim blerjeje nga 22.200 euro deri në 27.500 euro, pa përfshirë këtu vlerën e taksës doganore.*

54. Lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues vlerëson së pari se arsyetimi i Komisionit është i mangët dhe

se Komisioni duhet të thellohej më tej në hetimin e kësaj pasurie të marrë në shqyrtim, pasi për të ka dalë në konkluzione negative që ndikojnë vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit.

Së dyti, nga analiza e provave që lidhen me këtë pasuri, trupi gjykues konstaton se personi i lidhur, z. M.L., e ka përfituar këtë mjet, të cilin më pas ia ka dhuruar vëllait të tij, përmes kontratës së shkëmbimit të automjeteve me shtetasin M. M.

55. Nisur nga fakti që personi i lidhur, z. M.L., pretendon të ketë përdorur të ardhurat në vlerën 15.000 euro nga shitja e automjetit me targë {***}, sipas paragrafit 48 të këtij vendimi, për blerjen në vitin 2014 të autoveturës tip BMW në vlerën 14.000 euro, ku këtë të fundit e ka shkëmbyer me mjetin Mercedes Benz, me targë AA 011 IN, të shtetasit M. M., të cilën më pas ia dhuron vëllait, personit tjetër të lidhur të subjektit të rivlerësimit, z. A.L., dhe duke qenë se vlera e referencës së mjetit është rreth 3.750.000 lekë, sipas dokumenteve doganore, ndërkohë që në kontratën e dhurimit jepet si vlerë e mjetit shuma 1.000.000 lekë, trupi gjykues vlerëson se edhe çmimi i referuar në këtë kontratë dhurimi, si dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë bindëse lidhur me vlerën reale të mjetit.
56. Për sa më sipër, nuk qëndron as pretendimi i ngritur në ankim se vlera 1.000.000 lekë është vendosur *a priori* nga noterja, pasi në një kontratë noteriale janë palët ato që shfaqin vullnetin e tyre, ndërkohë që detyra e noterit është konkretizimi përmes hartimit dhe redaktimit të kontratës, si dhe "certifikimi" i kësaj shfaqjeje të vullnetit të palëve.
57. Gjithë sa më sipër, u bazua në aktet provuese si vijojnë:
- i. Kontratë dhurimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.10.2015.
 - ii. Kontratë shkëmbimi automjeti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.05.2014.
 - iii. Pagesë e taksës doganore ku çmimi i referencës është 3.750.000 lekë.
 - iv. Përgjigjet e pyetësorit nr. 2, datë 09.05.2018, të Komisionit.

Në përfundim, për këtë pasuri, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se *për pasurinë "autoveturë tip Mercedes Benz, me targa {***}", subjekti i rivlerësimit, me veprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi çmimi i referuar në kontratën e dhurimit, si dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk i krijojnë bindjen trupit gjykues për vlerën reale.*

58. Pasuria "automjet, tip Volkswagen, me targë {***}".

Për këtë pasuri, Komisioni ka arritur në përfundimin se *shitja e autoveturës me çmim 3 herë më shumë se çmimi i blerjes, në të vërtetë përbën veprim financiar të pajustificuar.*

59. Trupi gjykues konstaton se në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *blerjen e mjetit, tip "Volkswagen", me targë {***}, me kontratë nr. {***}, nr. {***} kol., datë 24.06.2010. Burimi i krijimit: kursime nga paga. Vlera: 100.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.*

Në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *shitjen e automjetit me targë {***}, shtetasit L.C, sipas kontratës, datë 02.05.2014. Vlera: 3.000 euro. Pjesa takuese: 100 %.*

Nga shqyrtimi i akteve në dosjen gjyqësore, rezulton se nuk ka informacion nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë për pagesën e tatimit fitimit mbi të ardhurat e realizuara si rezultat i shitjes së mjetit nga subjekti i rivlerësimit me një vlerë gati 4 herë më të lartë se çmimi i shitjes, pas afro 4 vitesh nga momenti i blerjes. Referuar pretendimeve të tij, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë shpenzimet e kryera për këtë mjet nga personi i lidhur, të cilat kanë sjellë rritjen e vlerës së tij. Në këtë vlerësim, çmimi i referuar në kontratën e shitjes, si dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk i krijojnë bindjen trupit gjykues për vlerën reale të shitjes.

*Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se për këtë automjet nuk i është kaluar barrë prove me rezultatet e hetimit, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim qëndron, por njëkohësisht konstaton që, pavarësisht se në rezultatet e hetimit nuk i është kaluar barra e provës, në pyetësorët e Komisionit subjektit të rivlerësimit i janë drejtuar pyetje dhe i janë kërkuar shpjegime lidhur me këtë pasuri. Për më tepër, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për shitjen e këtij automjeti kanë qenë thuajse të njëjta me shpjegimet e dhëna për shitjen e automjeteve me targë {***} dhe {***}, ku ka sqaruar se rritja e vlerës është rezultat i shërbimeve të nevojshme për mirëmbajtje dhe përmirësim, bërë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. M.L., si dhe nga mospërdorimi i tyre.*

60. Gjithë sa më sipër, u bazua në aktet provuese si vijojnë:

- i. Kontratë shitblerjeje automjeti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.06.2010, në vlerën 100.000 lekë.
- ii. Kontratë shitblerjeje automjeti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.05.2014, me shitëse Alma Liçaj dhe blerës L.C, për mjetin me targë {***}, në vlerën 3.000 euro.
- iii. Përgjigjet e pyetësorëve të Komisionit për subjektin e rivlerësimit.

Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se *për pasurinë "autoveturë, tip Volkswagen, me targë {***}", subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Liçaj, me veprimet e saj, ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi çmimi i referuar në kontratën e shitjes, si dhe shpjegimet e saj nuk i krijojnë bindjen trupit gjykues për vlerën reale të shitjes.*

61. Në përfundim, trupi gjykues bazuar në konkluzionet e mësipërme, në mbështetje të nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", vlerëson se vendimi nr. 78, datë 15.11.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 78, datë 15.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Liçaj.
2. Ky vendim është përfundimtar, me efekt të menjëhershëm.

U shpall sot në Tiranë, më datë 23.09.2019, ora 16:00

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

GJYQTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

GJYQTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUES

Luan DACI

nënshkrimi